



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosova



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Vitina

# *Informatë për Punën e Kryetarit të Komunës Janar – Qershor 2020*

*Viti, Korrik 2020*

# PËRMBAJTJE

## KAPITULLI I

- Hyrje .....	3
---------------	---

## KAPITULLI II

### **Raportet e Zyrave të Kryetarit ..... 8**

- Njësia e Auditimit të Brendshëm .....	8
- Njësia e Personelit .....	8
- Zyra Ligjore .....	10
- Zyra e Prokurimit .....	11
- Sektori për Komunitete dhe të Drejtat e Njeriut .....	12
- Njësia e të Drejtave të Njeriut .....	12
- Zyra Komunale për Komunitete e Kthim .....	12
- Zyra për Integritet Evropian .....	14
- Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun .....	14
- Lektori .....	15
- Zyra e Avokatit Publik të Komunës .....	15
- Zyra e Projekteve .....	16

## KAPITULLI III

### **Raportet e Drejtorive ..... 17**

- Drejtoria për Administratë .....	17
- Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim .....	21
- Drejtoria për Arsim .....	24
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale .....	31
- Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë.....	40
- Drejtoria për inspeksion .....	45
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport .....	47
- Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit .....	55
- Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi.....	57
- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural .....	59

# KAPITULLI I

## Hyrje

Të nderuar anëtar të Kuvendit të Komunës së Vitisë!

Më lejoni që para jush të prezantoj informatën e punës sime dhe kabinetit tim qeverisës, për periudhën Janar-Qershor 2020, i cila informatë pasqyron një përmbledhje të aktiviteteve të realizuara përgjatë kësaj periudhe. Angazhimi ynë është fokusuar në identifikimin e sfidave, përkatësisht objektivave në qeverisjen e mirë, të përgjegjshme dhe ligjore. Kundrejt këtyre objektivave, na është dashur të maten indikatorët e performancës, duke e nxjerr pasqyrën e saktë të gjendjes, si atë të identifikimit, planifikimit dhe implementimit të projekteve, mandej në shërbime publike, të situatës në arsim, shëndetësi, bujqësi, etj.

Siç e dini, ne që nga muaji mars kur jemi përballë me rastin e parë të paraqitjes me Covid 19, të një qytetari nga Komuna e Vitisë, jemi mobilizuar dhe kemi marrë masa të nevojshme e të domosdoshme për ta menaxhuar situatën edhe në aspektin shëndetësor, por edhe në atë social. Përgjatë kësaj periudhe, duke ju falënderuar të gjithë mekanizmave relevant, të cilët edhe shfrytëzoj rastin t'i falënderoj për gjithë përkushtimin e tyre, si: mjekët, infermierët dhe gjithë stafin shëndetësor të qendrave të mjekësisë familjare në Viti e Pozheran, pjesëtarët e policisë dhe Komandën e Stacionit Policor në Viti, njësinë e zjarrfikësve, partitë politike, Kryqin e Kuq, Shoqatën Humanitare Bamirëse "Nëna Terezë", organizatat dhe shoqatat tjera, bashkësitë fetare, këshillat e fshatrave, mediat qendrore e posaçërisht mediat lokale që i kemi pasur në mbështetje të vazhdueshme përgjatë kësaj periudhe. Ne kemi arritur të mbajmë situatën nën kontroll. Një falënderim për donatorët dhe diasporën që i janë përgjigjur ftesës sonë për të ndihmuar familjet në nevojë, si dhe gjithë ata që kanë kontribuar në forma të ndryshme që të kemi një situatë të menaxhueshme dhe nën kontroll në Komunën e Vitisë.

Punë të palodhshme dhe me shumë përkushtim, ka kryer dhe po kryen edhe tani Komiteti Komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim, i cili edhe ditëve të vikendit, edhe pas orarit të punës, por edhe në ditë festash, ka mbajtur për çdo ditë mbledhje, ka analizuar zhvillimet dhe është marrë seriozisht me situatën në kohë reale.

Në Komunën e Vitisë, gjatë gjatëmujorit janar-qershor 2020, kemi pasur gjithsej testime për Covid 19, 353. Prej tyre pozitiv kanë qenë 177, negativ 270, të shëruar 81, të hospitalizuar 11, persona në izolim 32. Në zbatim të masave të ndërmarra nga IKSHP-ja, kemi pasur për gati dy muaj edhe reduktim të daljeve dhe qarkullimit, e po ashtu edhe të reduktimit në masë të punës në ndërmarrjet publike e private, kështu që, ky bllokim dhe çrregullim, ka prekur ndjeshëm edhe zhvillimin e ekonomisë në Komunën e Vitisë.

Na është dashur që t'iu dalim në ndihmë familjeve në nevojë, por edhe familjeve tjera të cilave iu është rënduar ndërkohë gjendja financiare. Ne kemi arrit t'i shpërndajmë diku 4452 thasë miell (111300 kg), pako familjare 3810, pako higjienike 401, patate 400 thasë 5/1, patate 1600 thasë 25/1 dhe gjëra të nevojshme elementare për jetesë. Po ashtu është intervenuar përmes ekipeve mjekësore, në ato familje ku është paraqitë nevoja për asistencë. Njëkohësisht, kemi bërë edhe dezinfektimin e institucioneve publike, qendrat e mjekësisë familjare, objektet e kultit, institucionet e tjera që veprojnë në Komunën e Vitisë, objekteve shkollore. Kemi bërë klorifikimin e trotuareve, rrugëve e shesheve si në Viti, po ashtu edhe në lokalitetet e kësaj komune, posaçërisht të zonave të prekura me të infektuar. Pra, kjo është vetëm një pasqyrim në vija të trasha të aktiviteteve që kemi zhvilluar bashkë me Komitetin Komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe në bashkëpunim me mekanizmat tjerë që janë të përfshirë në këtë komitet.

Ne jemi aktiv dhe të përkushtuar edhe sot në menaxhimin e kësaj situate, me që kemi rritje të ndjeshme të të infektuarëve jo vetëm në Kosovë, por edhe në komunën tonë. Prandaj, zbatimi i masave mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së Virusit Korona, është më se i domosdoshëm dhe shfrytëzoj rastin të ju apeloj që

t'i bindeni rekomandimeve që vijnë nga Instituti i Shëndetit Publik, në mënyrë që ta ruajmë shëndetin tonë, ta ruajmë shëndetin e familjarëve dhe ta ruajmë në përgjithësi shëndetin publik të qytetarëve tanë.

Edhe pse në situatë epidemiologjike, jemi munduar vazhdimisht që mos të mungojë ofrimi i shërbimeve komunale për qytetarët e Komunës sonë në të gjithë sektorët.

Në vijim do t'i prezantojmë aktivitetet e drejtorive komunale, ku jetësimi i këtyre aktiviteteve ndikon drejtpërsëdrejti në mirëqenien e qytetarëve të komunës sonë:

## **ADMINISTRATË**

- Drejtoria për Administratë ka ofruar shërbime shumë kualitative për qytetarë;
- Është zvogëluar koha e pritjes për shërbime, pas kalimit të stafit të drejtorisë në objektin e ri;
- Janë lëshuar 12847 dokumente;
- Numri i qytetarëve që kanë kaluar verifikimin në sistemin e gjendjes civile është 53633.

## **BUJQËSI**

- Kanë përfituar shumë fermer, si në: bimë mjekuese aromatike dhe fidane të dredhëzës me infrastrukturë të kompletuar, dollape për pesticide sipas standardeve, kjo në bashkëpunim me Caritasin Zvicerran;
- 22 bletar janë pajisur me koshere me bletë dhe të gjitha pajisjet e punës;
- Fermerët janë pajisur me rezervuar të ujit, gypi për sistem të ujitjes pikë pikë, foli e zezë, tel për rrethojë, shtylla dhe pompa për spërkatje, plehra, kabinete metalike për ruajtjen e preparateve, ku në këto subvensioneve kanë përfituar gjithsej 13 fermerë në vlerën e mjeteve prej 72,000.00€;
- Nga Komuna e Vitisë dhe UNDP, fermerët kanë përfituar sistemin e ujitjes pikë pikë dhe fidane të bimëve aromatike, ku shuma e këtyre subvensioneve është 18,597.00€;
- Nga sektori i Pylltarisë është zbatuar plani operativ për mbrojtjen e pyjeve, i cili plan ka rezultuar të jetë i suksesshëm në mbrojtjen e pyjeve;
- Gjatë situatës së krijuar epidemiologjike, 450 fermerë janë pajisur me NIF nga komuna, kjo me rekomandim të Ministrisë së Bujqësisë, në mënyrë që fermerët të vazhdonin punën e tyre në zhvillimin e kulturave të ndryshme bujqësore edhe në kohën e karantinimit të Komunës.

## **ARSIMI**

- Ngritja e kapaciteteve në mësimdhënie dhe mësimnxënie, si dhe krijimi i kushteve më të mira në gjithëpërfshirjen;
- Janë mbajtur debate, konsulta për tema të ndryshme rreth dukurive negative në shkolla;
- Është organizuar transporti i nxënësve për fshatrat Letnicë dhe Podgorc, si dhe transporti i nxënësve me nevoja të veçanta për në shkollën speciale në Prizren;
- Janë furnizuar shkollat me rekuizita sportive, etj;
- Që nga evidentimi i rasteve pozitive me COVID 19, të gjitha aktivitetet e punës në shkolla janë zhvilluar online, me anë të platformave ZOOM, GOOGLE MEET, GOOGLE CLASSROOM, ËHATSAPP, VIBER etj, duke i përfshirë ligjëratat me nxënës, takime me mësimdhënës, me prindër, me MASHT, trajnime me organizata të ndryshme.

## **FINANCA, EKONOMI DHE ZHVILLIM**

- Përgatitja e të gjitha projekteve kapitale;
- Inkasimi i tatimit në pronë 40.89%;
- Në bashkëpunim me MTI është bërë identifikimi i vendeve turistike në Komunën e Vitisë
- Mbështetja e investitorëve për investime në komunë.

## **KULTURË, RINI DHE SPORT**

- Janë organizuar aktivitete të ndryshme kulturore, sportive dhe letrare;
- Është duke u bërë vazhdimi i punimeve në: palestrën e sportit në Drobesh, stadiumi në Viti, Stadiumi në Pozheran dhe Stadiumin në Sadovinën e Jerlive;
- Aktivitetet tjera të parapara në Planin e këtij dikasteri janë anuluar të gjitha, shkak i situatës së krijuar epidemiologjike në vend.

## **URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT**

- Shqyrtimi i 7 kërkesave për leje ndërtimore, 4 kërkesave për pëlqim urbanistik, 9 kërkesave për kushte të ndërtimit;
- Shqyrtimi i 9 kërkesave për Informata urbanistike;
- Shqyrtimi i 1 kërkesë për Leje Mjedisore Komunale;
- Shqyrtimi i 1 kërkesë për leje përdorimi;
- Shënimi i datave me rëndësi për pastrimin e ambientit;
- Janë përcaktuar 7 zona me vlera të mbrojtura të natyrës për të cilat është marrë vendim në Kuvendin Komunal, si dhe aktivitete tjera të vazhdueshme në fushëveprimtarinë e kësaj Drejtorie.

## **SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË**

- Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit dimëror dhe verorë;
- Eliminimi i deponive ilegale nëpër fshatra;
- Mirëmbajtja e kanalizimeve dhe ujësjellësve;
- Pastrimi i hapësirave publike, ku është zbatuar në përpikëri Plani për mirëmbajtjen e hapësirave të hapura publike, duke përfshirë: parqet, sheshet, shëtitoren, shtratin e lumit “Morava”, sipërfaqet gjelbëruese, terrenet sportive, hapësirat për parkim automjetesh, hapësirat e objekteve fetare dhe monumentale, rrugët, trotualet, tregjet, varrezat e dëshmorëve, etj;
- Mirëmbajtja e ndriçimit publik;
- Inspektimi i objekteve publike dhe private nga inspektori i preventives ndaj zjarreve, ku kanë qenë gjithsej 54 inspektime;
- Intervenime nga shërbimi i zjarrfikjes, ku kanë qenë 440 dalje të përgjithshme në teren, duke përfshirë: intervenimet në zjarre (205), aksidente rrugore, dhe shërbime të ndryshme;
- Janë bërë dezinfektime të rregullta nga shërbimi i zjarrëfikse në të gjitha vendet ku ka qenë e nevojshme.

## **SHËNDETËSI**

- Promovimi i shëndetit përmes ligjëratave dhe aktiviteteve me qytetarë, shënimi i ditëve botërore të shëndetit (aktivitete para pandemisë);

- Është bërë përrurimi i QMF-së në Sllatinë të Epërme, si dhe udhëheqja e procedurave të prokurimit për dunizim me autoambulancë si dhe për renovim të QKMF-së;
- Ofrimi i shërbimeve për qytetarë në mjekësinë primare dhe specialistike, ku numri i shërbimeve të ofruara për periudhën gjashtëmujore 2020 është 140,802;
- Janë pranuar pajisje mbrojtëse dhe material i nevojshëm për personelin shëndetësor të QKMF-se dhe qendrave përcjellëse të saj, ku këto pajisje janë pranuar nga donatorë të shumtë, për të cilën shfrytëzojmë rastin t'i falënderojmë të gjithë për kontributin që kanë treguar në kohën e shëndetit publik emergjent;
- Shtohet numri i analizave laboratorike edhe me CRP (Proteina-reaktive);
- Vazhdimi i marrëveshjes për kontrollimin e ujit me Institutin Regjional të Shëndetit Publik;
- Vazhdimi i bashkëpunimit mbi asgjësimin e mbetjeve medicinale në marrëveshje me Spitalin Rajonal të Gjilanit.
- Vazhdimi i kontratës me Caritas Kosova për ofrim të shërbimeve mjekësore nëpër familje ku paraqitet nevoja për ndihmë mjekësore.
- Ofrimi i shërbimeve nga Qendra për Punë Sociale, shërbime këto që janë në fushëveprimtarinë e kësaj Qendre.

### **KADASTËR, PRONË DHE GJEODEZI**

- Janë shqyrtuar 1902 kërkesa për shërbime kadastrale dhe gjeodezike, si: transaksione të pronave të paluajtshme, shitblerje, falje, trashëgimi, hipoteka, servitute dhe barra reale e të tjera si dhe historiate të pronave, kopje plani dhe çertifikata të ndryshme pronësore;
- Realizimi i të hyrave mbi 93%;
- Ofrimi i shërbimeve përmes sistemeve më të avancuara;
- Tërheqja e investimeve për çështjet pronësore.

### **INSPEKSIONI**

- Është bërë Inspektimi i vazhdueshëm gjatë pandemisë për të gjitha rastet duke përcjellë masat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe rekomandimeve të IKSHP (Institutit Kombëtar i Shëndetit Publik), si dhe sanksionimi i të gjithë atyre që nuk i kanë zbatuar këto masa;
- Janë asgjësuar rreth 23,5 tonë artikuj ushqimor të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet për konsum;
- Vazhdimi i sinjalistikës (shenjave) vertikale dhe horizontale për siguri në komunikacion;
- Inspektimi i vazhdueshëm kushteve tekniko-sanitare i lokaleve të biznesit, mikrobankave, barnatoreve humane furrave të bukës etj;
- Inspektimi ushqimeve mbi cilësinë e tyre në të gjitha hipermarketet, marketet tregtare dhe bizneset tjera;
- Preventiva në kontrollin e sëmundjeve tek kafshët dhe bletët , si dhe asgjësimi i kafshëve të ngordhura në mënyrën më të mirë të mundshme;
- Mbikëqyrja e trajtimit të qeneve endacak;
- Kontrollimi i vazhdueshëm i ujit për qytetarë, i cili në shumicën e analizave gjendja është më e mire;
- Inspektimi i vazhdueshëm i ambientit, sanksionimi i ndotësve dhe ndalimi i shumë aktiviteteve ndotëse;
- Inicimi i shumë lëndëve në Gjykatë dhe kallëzime penale në Prokurori i lëndëve për raste të shkeljeve të ligjit në të gjitha sferat e kontrollit.

**Projektet investive për vitin 2020**

<b>1</b>	<b>Participimi i projekteve me donator në proces të realizimit</b>	<b>198.000,00</b>
<b>2</b>	<b>Asfaltimi i rrugëve rurale në proces te realizimit</b>	<b>280.000,00</b>
<b>3</b>	<b>Asfaltimi i rrugëve në fshatin Smirë, Kolishtë dhe Terpezë në proces të realizimit</b>	<b>189.150,00</b>
<b>4</b>	<b>Rregullimi i kanalizimeve ne proces te realizimit</b>	<b>150.000,00</b>
<b>5</b>	<b>Rregullimi i rrugëve me zhavor ne proces te realizimit</b>	<b>110.000,00</b>
<b>6</b>	<b>Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik ne proces te realizimit</b>	<b>285.000,00</b>
<b>7</b>	<b>Rregullimi i hapësirave gjelbëruese – publike ne proces te realizimit</b>	<b>45.000,00</b>
<b>8</b>	<b>Rregullimi i fushave sportive ne proces te realizimit</b>	<b>83.000,00</b>
<b>9</b>	<b>Rregullimi i lumenjve (kanaleve) dhe prockave ne proces te realizimit</b>	<b>109,800,00</b>
<b>10</b>	<b>Zgjerimi i urave ne proces te realizimit</b>	<b>15.000,00</b>
<b>11</b>	<b>Fusha ndihmëse e futbollit ne Pozheran ne proces te realizimit</b>	<b>130.000,00</b>
<b>12</b>	<b>Riparime nëpër shkolla ne proces te realizimit</b>	<b>70.000,00</b>
<b>13</b>	<b>Renovim i ambulantave ne proces te realizimit</b>	<b>10.000,00</b>
<b>14</b>	<b>Furnizim me autoambulanc ne proces te realizimit</b>	<b>40.000,00</b>
<b>15</b>	<b>Ndërtimi i ambulantes në fshatin Terpezë në proces te realizimit</b>	<b>20.000,00</b>
<b>16</b>	<b>Rregullimi i sheshit ne Viti në proces te realizimit</b>	<b>220.951,25</b>
<b>17</b>	<b>Rregullimi i dy fushave sportive ne proces te realizimit</b>	<b>40.000,00</b>
<b>18</b>	<b>Rregullimi i rrugës Viti-Sllatinë në proces te realizimit</b>	<b>130.000,00</b>
	<b>Gjithsej</b>	<b>2.051.101,25</b>

## KAPITULLI II

### Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB)

Në kuadër të këtij raporti të punës, Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB), për punën e vet është bazuar kryesisht në Planin vjetor të punës për vitin 2020, ndërsa bazë ligjore ka pasur Ligjin Nr.06/L-21 për KBFP, Udhëzimet administrative për auditim të brendshëm, doracakun e auditimit të brendshëm, statutin e auditimit të brendshëm, instruksionet lidhur me standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm.

Sipas Planit vjetor të NJAB-së, për vitin 2020, në gjashtëmujorin e parë kanë qenë të planifikuara të kryhen gjithsejtë 4 auditime, ndërsa në këtë gjashtëmujor është bërë vetëm një auditim.

Arsyet e moskryerjes së auditimeve sipas planifikimit janë: 1. përfshirja e Komunës së Vitisë nga sëmundja e pandemisë nga Virusi Corona 19, ku për dy muaj me radhë ne ishim të izoluar në karantinë dhe pas kësaj kemi punuar me staf të reduktuar, ku një numër i zyrtarëve nuk ishin në punë dhe na e ka pamundësuar kryerjen e auditimeve sipas kohës së paraparë; 2. Renovimi i objektit të komunës, ku e kemi pasur të pamundur që të kryejmë punët e përditshme; 3. Mosofrimi i dokumentacionit të nevojshëm nga disa zyrtarë në kohën e kërkuar.

Auditimet e kryera në periudhën raportuese me të gjeturat dhe rekomandimet, dhe drejtimi i shkurt për secilin auditim.

#### 1.1 Emërtimi i auditimit:

#### Auditimi Nr. DSHS- 20/01

**Tema e Auditimit:** Zbatimi i Procedurave të Prokurimit Publik në Komunën e Vitisë për periudhën 30.09/2018 deri 31.12/2019

### Njësia e Personelit

Njësia e Personelit për pjesën e parë të vitin 2020 në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës ka hartuar planin e Personelit në bazë të udhëzimeve të cilat janë dhënë nga Ministria e Administratës Publike, Departamenti i Shërbimit Civil si dhe Drejtorit përkatës në veçanti me Drejtorin për Buxhet dhe Financa Njësia e Personelit ka respektuar planin të cilin e ka aprovuar DSHAC-ja dhe konform ligjit dhe aktëve tjera ka proceduar sipas kërkesave të Drejtorive përkatëse dhe në harmoni me planin e personelit ka zhvilluar procedurat e rekrutimit, dhe pozitat të cilat kanë mbetur të lira e që kanë qenë të parapara me plane janë plotësuar krahas kësaj Njësia e Personelit ka zhvilluar procedura sipas Ligjit mbi Shërbimit Civil, dhe Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore të cilat rregullojnë sferën e marrëdhënies së punës për shërbime të veçanta.

Njësia e Personelit ka zhvilluar të gjitha procedurat për pozitat të cilat i ka pasur në plan të personelit për pjesën e parë të vitit 2020, përjashtim bëjë pozitat të cilat është dashur që të plotësohen që nga muaji janar deri në qershor, ndërsa ato me shërbime të veçanta janë zhvilluar konform Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore.

Njësia e Personelit gjatë periudhës janar-qershor 2020, ka bërë skenimin e dosjeve personale të shërbyesve civil të cilët shërbyes civil kanë ndjekur trajnime të ndryshme e të cilët janë pajisur me çertifikata. Njësia e Personelit sipas kërkesave të ministrive dhe agjensionëve të cilat kanë kërkuar raporte për punën dhe aktivitete e njësisë këto raporte i ka dërguar me kohë.



Nr.	Emri i aktit të lëshuar	Nr. i lëndëve të kryera	Vërejtje
1	Mbajtja evidencave te pushimeve vjetore me kërkesa	120	
2.	Kërkesat dërguar M.A.P. për aprovim për lejimin e konkurseve publike	12	
3.	Vërtetime mbi marrëdhënien e punës për Shërbyesit Civil.	35	
4.	Vërtetime të ndryshme për praktikantet të cilit e kanë kryer praktiken në Administratën Komunale.	6	
5.	Shpallje të konkurseve	12	
6.	Formular mbi pagat	17	
7.	Formular për punëtorë të rinj	0	
8.	Formular për ndryshime	15	
9.	Formular për pagesa retroaktiv	2	
10.	Intervistim me shkrim	12	
11.	Intervista me gojë	12	
12.	Përshkrimi i vendeve të punës	12	
13.	Fletëparaqitje disiplinore te bëra nga përgjegjësitë kompetent	0	
14.	Ankesa te shërbyesve civil dhe qytetarëve	3	
15.	Kontrata me SHV për 4 muaj	37	
16.	Kompletim i dosjeve personale	75	
17.	Dërgimi i formularëve për deklaram te pasurisë për te gjithë këshilltaret	43	
18.	Formular për ndryshime për ndërrim te llogarive rrjedhëse	14	
19.	Vendime për Punëtorë të pensionuar parakohshëm	0	
20	Akt emërimet	0	
21	Vendim për largim nga puna për shkak të vdekjes.	6	
22	Vendim për pensionim të pleqërisë	3	
23	Anulim te konkursit	7	
24	Lëshime te vendimeve për te pensionuarit-Kompensim një page.	3	
25	Konkurse me shërbime te veçanta	13	
26	Raporte për MAP- 3mujorshe	2	

27	Përgjigje ne ankesë KPMK	0	
28	Përgjigje në informata të kërkuara nga KPMK	0	
29	Vendime të pushimeve të lehonisë	0	
30	Vendime për rifillim te punës	0	
31	Numri i përgjithshëm për vlerësimet e punës të shërbyesve civil	112	
32	Transfer prej KK. Viti ne K.K. Prishtinë	0	

## Zyra ligjore

Zyra Ligjore për 6 muajt e parë të vitit 2020 kontributin e saj e ka dhënë edhe në fushën e interpretimit ligjor për të gjitha nevojat Komunale.

Në kontest të gjithë kësaj, duhet veçuar kontributin në harmonizimin e këtyre akteve nënligjore normative Komunale me ligjet në fuqi si në vijim: Përgjigje në kërkesë për raportin e komisionit për mini hidrocentral të datës 06.01.2020; Interpretim ligjor, të datës 06.01.2020; Njoftim për stacionin policor të Vitisë të datës 09.01.2020; Mendim profesional për zv. kryetarin, të datës 09.01.2020; Interpretim ligjor për ekzekutimin e ligjit të pagave, të datës 14.01.2020; Shqiptimi i masave dy rojeve te pyjeve, të datës 22.01.2020; Përgjigje në kërkesë, të datës 24.01.2020; Interpretim ligjor të datës 24.01.2020; Udhëzime juridike për shqiptimin e masave shërbyesve civil, të datës 24.01.2020; Përgjigje për qasje në dokumente publike, të datës 27.01.2020; Përgjigje për qasje në dokumentet publike, të datës 27.01.2020; Interpretim ligjor të datës 28.01.2020; Interpretim ligjor për bartjen e kioskave, të datës 28.01.2020; Njoftim për bartjen e rrymës dhe ujit, të datës 28.01.2020; Interpretim ligjor, të datës 28.01.2020; Përgjigje në kërkesë të datës 28.01.2020; Përgjigje në kërkesë të datës 28.01.2020; Përgjigje në kërkesë, të datës 28.01.2020; Interpretim ligjor, të datës 29.01.2020; Interpretim ligjor të datës 29.01.2020; Kontratë të datës 04.02.2020; Kontratë të datës 04.02.2020; Kontratë të datës 04.02.2020; Kontratë e datës 04.02.2020; Kontratë Fatime e datës 05.02.2020; Kontratë e datës 05.02.2020; Kontratë e datës 05.02.2020; Kontratë e datës 05.02.2020; Kontratë e datës 05.02.2020; Kontratë e datës 05.02.2020; Kontratë e datës 05.02.2020; Kontratë e datës 05.02.2020; Vendim për këshillat e fshatrave dhe lagjet urbane të datës 05.02.2020; Kërkesë Agjensionit për privatësi, të datës 18.02.2020; Vendim për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së parë të rregullt të Kuvendit Komunal, të datës 19.02.2020; Vendim për aprovimin e planit të punës së datës 19.02.2020; Vendim për aprovimin e punës të komitetit, të datës 19.02.2020; Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës së datës 19.02.2020; Vendim për mbrojtjen e natyrës II, të datës 19.02.2020; Vendim për mbrojtjen e natyrës III të datës 19.02.2020; Vendim për mbrojtjen e natyrës IV, të datës 19.02.2020; Vendim për krijimin e qasjes së parcelës Nr. 3760-0 në rrugë publike me Nr.2592-11 përmes parcelave me Nr. 2582-6 dhe Nr.2582-8, të datës 19.02.2020; Vendim për Rregullaritet ligjor të datës 21.02.2020; Vendim për Rregullaritet për pranim të punëve nga ana e inxhinierave të Komunës, të datës 21.02.2020; Përgjigje për qasje në dokumente publike të datës 24.02.2020; Kërkesë për Ministrinë në Administratën Publike të datës 02.03.2020; Urdhëresë e Kryetarit për respektim të orarit të punës të datës 02.03.2020; Shqyrtimi i memorandum mirëkuptimit, të datës 02.03.2020; Vendim, të datës 06.03.2020; Interpretim ligjor, të datës 06.03.2020; Urdhëresë për ndalimin e duhanit në vetura zyrtare 06Z, të datës 11.03.2020; Interpretim ligjor-drejtoria e bujqësisë, të datës 11.03.2020; Propozim vendim për themelimin e vendparkingjeve, të datës 11.03.2020; Shqyrtimi i udhëzimit administrativ

Nr.MA-Nr.10/2007,të datës 11.03.2020; Propozim vendim –plani i veprimit për efqiencë, të datës 11.03.2020; Interpretim ligjor , të datës 11.05.2020; Interpretim ligjor, të datës 12.05.2020; Urdhëresë, të datës 15.05.2020; interpretim ligjor transferi i nëpunësve civil, të datës 15.05.2020; Vendim për emërimin e Skender Ahmetit, të datës 20.05.2020; Vendim për shpalljen në diskutim publik të datës 22.05.2020; Vendim i planit komunal për menaxhim të mbeturinave, të datës 22.05.2020; Vendim për aprovimin e planit të punës se komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara, të datës 22.05.2020; Vendim për shpalljen në diskutim publik, të rregullores për mbeturina, të datës 22.05.2020; Vendim për aprovimin e strategjisë komunale kundër dhunës në familje dhe planit të veprimit, të datës 22.05.2020; Vendim për certifikatën e objektit të përdorimit, të datës 03.06.2020; Vendim për formimin e komisionit evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në sektorin e bujqësisë, të datës 09.06.2020; Padi kundërshtimi, të datës 09.06.2020; Procesverbal për negociim të ofertave të datës 10.06.2020; Marrëveshje bashkëpunimi, të datës 11.06.2020; Përmirësim të vendimit, të datës 17.06.2020; Njoftim Bashkim Hasani, të datës 17.06.2020; Interpretim ligjor, të datës 17.06.2020; Vendimi i arenës të datës 18.06.2020; Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet UBT-së dhe Komunës së Vitisë, të datës 22.06.2020; Vërtetim, të datës 22.06.2020; Interpretim ligjor me inzhiniera , të datës 25.06.2020; Vendim i 26.06.2020; Propozim vendim për caktimin e komisionit për zgjidhjen e drejtorëve dhe zv.drejtorëve, të datës 26.06.2020; Lëndë përmbartimore, të datës 06.07.2020; Interpretim ligjor sipas qarkores ligjore të datës 06.07.2020; Aplikacioni i zonës ekonomike, të datës 07.07.2020; Konkursi për zonën ekonomike, të datës 07.07.2020; Kontrata për zonën ekonomike, të datës 07.07.2020.

## Zyra e Prokurimit

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020, duke u bazuar në kërkesat e njëjësive shpenzuese zyra ka inicuar **40** aktivitete të prokurimit. Duke i ndarë ato sipas kategorive ose llojit të ndara në punë, shërbime dhe furnizime, kemi këto të dhëna; 9 aktivitete me lëndë prokurimi Shërbime, 16 aktivitete me lëndë prokurimi Punë dhe 15 me lëndë prokurimi Furnizime. Nga këto aktivitete, 24 janë përmbyll si aktivitete, tjerat janë në procedurë. Ndërsa lloji i procedurave e udhëhequra janë si vijon: 24 raste është përdorë procedura e hapur, 8 raste procedura e kuotimi i çmimit dhe 2 aktivitete procedurë me Vlera minimale, dhe 5 aktivitete procedura e negociuar pa publikim te njoftimit per kontratë. Prej këtyre aktiviteteve të zhvilluara: 24 aktivitete të prokurimit, janë përmbyll dhe janë finalizuar me nënshkrimin e kontratave. Ndërsa; **16** aktivitete të prokurimit janë në zhvillim apo procedim të mëtutjeshëm. Nga 84 aktivitete te prokurimit te parapara për vitin 2020, ne këtë 6 mujor janë realizuar 48 % e aktiviteteve te gjithmbarshme te planifikuara

Zyra e Prokurimit përveç këtyre aktiviteteve ka realizuar edhe pagesa për Operatoret Ekonomik që kanë kryera punë, furnizime apo shërbime sipas kontratave që kanë me komunën tonë. Shuma e përgjithshme e shprehur në vlerën e kontratave të lidhura është **1,018,028.89 €**.

Zyra e Prokurimit gjatë kësaj periudhe kohore janë lëshuar **566 Urdhërblerja** për pagesën e OE të kontraktuar, duke udhëhequr lëndët për kompletim dhe janë dërguar në Thesar për pagesë, gjegjësisht ekzekutim. Zyra e Prokurimit ka kryer edhe **80** rekomandime për vendimet e ndryshme të komisioneve për hapje dhe vlerësim dhe komisioneve tjera.

## **Sektori për Komunitete dhe të Drejtat e Njeriut**

Ky raport gjashtëmuor për periudhën **Janar – Qershor 2020**, i zyrës së udhëheqësit të sektorit për komunitete dhe të drejtave të njeriut, është përgatitur, bazuar në kërkesën nga Zyra e Kryetarit të Komunës së Vitisë. Raporti, ka për qëllim të ofroj Zyrës së Kryetarit të Komunës, informata për aktivitetet e zhvilluara, të kordinuara përmes Zyrës së Udhëheqësit të Sektorit për Komunitete dhe të Drejtat të Njeriut, me zyrën për komunitetet dhe kthim, zyrën për riintegrim të personave të riatdhesuar dhe po kështu edhe zyrës/njësia për të drejtat e njeriut.

### **Njësia e të Drejtave të Njeriut**

Kjo njësi është e mandatar për të monitoruar respektimin e të drejtave të njeriut në nivel komunal, veçanërisht në këto fusha: mundësitë e barabarta, kundër-diskriminimin, barazinë gjinore, të drejtat e fëmijëve, personat me aftësi të kufizuara, të drejtat e komuniteteve, përdorimin e gjuhëve dhe antitrafikimin me qenieve njerëzore. Ato janë gjithashtu, përgjegjës për adresimin e kërkesave të banorëve të Komunës së Vitisë në lidhje me të drejtat e njeriut.

Që nga fillimi i vitit 2020, vendi ynë është përballur me një gjendje emergjente në shëndetësi si pasojë e pandemisë nga Covid 2019, ku kjo gjendje ka vazhduar për muaj të tërë duke bërë që aktivitetet që lidhen me fushëveprimin e kësaj zyre të jenë të pakta. Me kërkesë të znj. Kadrije Gashi Myrtaj, udhëheqëse e divizionit për avancimin e të drejtave të njeriut në komuna në kuadër të MAPL-së, në muajin prill, përmes komunikimit elektronik, unë e kam informuar në lidhje me ecurinë e zhvillimit të projektit të Personave me Aftësi të Kufizuar, projekt ky i cili ka filluar nga muaji tetor i vitit 2019 dhe që ka për qëllim krijimit të kushteve të barabarta për Persona me Aftësi të Kufizuar për të siguruar një qasje më të mirë fizike në Institucionet publike dhe private. Fokusi i shkëmbimit të informatave ka qenë mbi rëndësitë dhe nxjerrjen e vendimit të veçantë nga kryetari i komunës për përcaktimin e Grupit Punues (GP) profesional, i cili më pas do të hartoj PKO (Plani Komunal Operativ) që do të përcaktonte prioritetet për përmirësimin e infrastrukturës, 4 incizimi i qytetit duke identifikuar pikat kyçe që mundësojnë qasje nëpër objekte dhe infrastrukturë. Po kështu, gjatë kësaj periudhe raportimi, kam kontaktuar me Luljeta Ibishi, zyrtare për të drejtat e njeriut në MAPL.

Me kërkesë të këtij institucioni, në bisedën me nënkryetarin e komunës z.Aliu, nëpërmjet komunikimit onllajn, unë e kam informuar këtë institucion me vendimi për Grupin Punues Profesional që është nxjerrë, i cili është në përbërje prej tre inxhinierëve të fushës infrastrukturore. (GP) profesional, iu janë dhënë detyrat për fillimin e aktivitetit në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara në vendimin e kryetarit.

Meqenëse ky ekip në komunën e Vitisë është duke u ballafaquar me disa probleme, tema e bashkëbisedimit (online) nga pjesëmarrësit ishte pikërisht adresimi dhe zgjidhja e mundshme në afatshkurtë e këtyre çështjeve. Ndër problemet kyçe të identifikuar është mungesa e kompensimit financiar të anëtarëve të përhershëm të Ekipit Vlerësues të komunës që rrjedhimisht edhe ka ndikuar në paraqitjen e pengesave në ushtrimin e funksionit ekipor sepse një pjesë e anëtarëve tanimë janë larguar. Çështje tjetër esenciale është mungesa e një Dhome Miqësore e cila do të mundësonte vlerësimin e nevojave pedagogjike të fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe njëkohësisht do të ruante privatësinë e secilit fëmijë.

### **Zyra Komunale për Komunitete e Kthim**

Gjatë kësaj periudhe kohore janë kryer këto aktivitete:

- Janë riatdhesuar:

Nga Gjermania:

-Me familje: tri familje, një familje me 3 anëtarë\*(bashkëshortët dhe djali), një familje me 4 anëtarë (bashkëshortët dhe dy fëmijë ,djem) dhe tjetra me 6 anëtarë (bashkëshortët dhe 4 fëmijë, tri vajza dhe një djalë)

-Pa familje:7 persona

Nga Franca:

-Me familje- Një çifte bashkëshortor

-Pa familje -1 person

Nga Zvicra:

-Me familje-Ska

-Pa familje-1 person

Nga Shtetet tjera: Ska

Gjithsej të riadhesuar:24 persona

- Ndhimë-Përfitues sipas rregullores 13/2017 janë:

Një familje me 4 anëtarë ( banim përmes qeras 2 herë nga gjashtë muaj, plus dhe 6 të tjerë për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike)

\*Pako ndihmëse- ska

\*Trajtim mjekësor- ska

\*Ndërtim-renovim të shtëpisë-ska

\*Pako e orendive shtëpiake –ska

- Kërkesa 3

- Përgjigje 3

- Vërtetim mbi bazën e dëshmimeve 1

- Me formular të riadhesimit janë pajisur 11 persona, kërkesa kryesisht për kompletim të dokumentacionit që iu është kërkuar palëve nga Zyra e Komunale e Punësimit

- Komisioni Komunal për Riintegrim dhe Riadhesim ka mbajtur tri takime

VENDIME-vetëm dy VENDIME për banim përmes qerasë( 1 VENDIM dy herë nga gjashtë muaj plus 1 VENDIM edhe për 6 muaj të tjerë )

- Janë monitoruar rastet që ishin për monitorim në bashkëpunim: ZKKK, ZKK-ja Regjionale dhe Zyra Komonale e Punësimit

- Bashkëpunim me organizatat si: CRP/K-Programi për të Drejtat Civile në Kosovë, Partners Kosova, AËO-ja (Organizatë që ndihmon të riadhesuarit nga një regjion i Gjermanisë me seli në Nyrberg)

- Bashkëpunim dhe takime (dy takime pune) me Karitasin Zvicerran, njëri takim me Zyren Komonale të Punësimit dhe tjetri me QPS-programi SUREP (kthimi i qëndrueshëm i personave të riadhesuar përmes RIINTEGRIMIT socioekonomik)

- Takime pune në MPB-4 takime

- Letër drejtoreshës së Karitasit Zvicerran, përmes kryetarit të Komunës, për mundësinë e një marrëveshjeje bashkëpunimi

- Është përgatit plani gjashtëmujorit parë 2019

- Konferencë njëditore me PARTNERS KOSOVA-OJQ(merret me çështjen e RIATDHESIMIT) në Prishtinë

- Takim pune në Mitrovicë me DAKONIE KOSOVA-OJQ ndihmon të riadhesuarit nga rrethi i NYRBERGUT

- Trajnim 4 ditor për unifikimin e Planit të Veprimit për Riintegrimin e Qëndrueshëm për Personat e riadhesuar për periudhën 2019-2022

PS: Me rastin e tërmetit , nga zona e prekur (kryesisht nga Durrësi me rrethinë), janë pranuar, sistemuar dhe ndihmuar 9 familje me 46 anëtarë (janë ndihmuar nga Komuna, Kryqi i Kuq, Nëna Terezë dhe nga popullate e komunës sonë e në veçanti nga Këshilli i fshatit Gjylekar.

## **Zyra për Integritim Evropian**

Zyra Komonale për Integritim Evropian, zyrtari për integritim evropian gjatë periudhës Janar – Qershor 2020, ka kryer këto aktivitete:

1. Kemi profilizuar Planin Kombëtar për Integritim Evropian 2020 dhe iu ka rekomanduar Zyrës së Kryetarit të Komunës, Zyrës së Kryesuesit të Kuvendit, drejtorive komunale dhe zyrave ndihmëse të Kryetarit të Komunës, për plotësimin e objektivave që dalin nga Plani Kombëtar për Integritim Evropian janar-qershor 2020;
  2. Kemi përcjell punimet e takimeve të KPF-së;
  3. Kemi përcjell punimet e seancave të Kuvendit të Komunës;
  4. Kemi marrë pjesë në komisionin për riintergrim, në bordin e drejtorëve;
  5. Kemi udhëhequr me komisionin për hapjen e kutive të ankesave ,si dhe një varg aktivitete të ndryshme të organizuar nga Kryetari i komunës dhe drejtoritë përkatëse.
- Pandemia ka qenë hendikep për shtrirjen e aktiviteteve në plotni.

## **Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun**

Gjatë vitit 2020, respektivisht periudhës janar-qershor, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun e Komunës së Vitisë, ka qenë e angazhuar në informimin sa më objektiv dhe të shpejtë për zhvillimet aktuale të Institucioneve komunale.

Gjatë kësaj periudhe, që është karakterizuar kryesisht me gjendjen e pandemisë të shkaktuar nga virusi COVID-19 kjo zyre megjithatë ka vazhduar punën duke përcjellë të gjitha aktivitetet të rregullta por edhe të veçanta si dhe ka njoftuar publikun e gjerë për zhvillimet e gjithmbarshme në komunën e Vitisë. Gjitha këto ngjarje, janë pasqyruar në publikim në Web faqen e komunës [kk.rks-gov.net/viti](http://kk.rks-gov.net/viti) si dhe në adresën e komunës së Vitisë në rrjetin social Facebook.

- Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, gjatë kësaj periudhe ka publikuar 34 dokumente mbi procedurat e konkurrimit dhe pranimin në punë si dhe 70 dokumente mbi procedurat e prokurimit publik si: Kontratat e Nënshkruara, Njoftime për Kontratë, Njoftime për dhënie të Kontratës, Planet dhe Raportet e Prokurimit Publik.
- Janë publikuar gjithashtu edhe 63 Njoftime publike, 18 Vendime të Kuvendit Komunal, 24 Vendime të Kryetarit të Komunës, të gjitha draft dokumentet të cilat janë paraparë të shqyrtohen në Komitetin për Politikë e Financa dhe Kuvendin Komunal.
- Kemi harmonizuar dhe funksionalizuar uebfaqën në gjuhën serbe.
- Po ashtu janë publikuar edhe disa Plane e Raporte si dhe Dokumentet të cilët ndërlihdën me shpenzimin e parasë publike.
- Një bashkëpunim të ndërsjellët dhe shumë të mirë, kemi pasur me mediat lokale dhe ato qendrore. Përmes adresave elektronike, gjitha mediave të shkruara, elektronike dhe agjencive të lajmeve u janë dërguar lajmet për ngjarjet nga komuna e Vitisë edhe përmes fotografive.

- Zyra për Informim publik ka përcjell gjitha aktivitetet e kryetarit të komunës, apo edhe zyrtarëve të tjerë komunal në terren.
- Pritjen e delegacioneve vendore dhe të huaj në komunën tonë.
- Në kuadër të zyrës janë bërë specifikimet e shpenzimeve për publikime: Shpallje, Konkurse, tenderë, Njoftime etj.
- Ndërkaq në kuadër të punës së Zyrës për Informim Publik, janë pranuar dhe shqyrtuar 15 Kërkesa për Qasje në Dokumentet Publike.
- Zyra për Informim ka marrë pjesë pothuajse në të gjitha trajnimet, punëtorit dhe mbledhjet e ndryshme për ndryshimin e pakos ligjore për Transparencë dhe është në fazën e finalizimit të ndryshimit të Rregullores për Transparencë si dhe të hartimit të Planit të Veprimit për Transparencë për periudhën 4 vjeçare.
- Gjithashtu Zyra për Informim konkretisht Koordinatori Komunal për përfomancë, ka ndjekur të gjitha trajnimet lidhur me SMPK si dhe në bashkëpunim me zyrtarët raportues ka përgatitur raportin e SMPK-së për vitin 2019.

## Lektori

Gjatë periudhës kohore Janar - Qershor 2020, si lektor Administratës së Komunës dhe i Kuvendit të Komunës së Vitisë, kam kryer punë dhe detyra të punës sipas përgjegjësisë zyrtare dhe përshkrimit të detyrave të vendit të punës. Kam lekturuar dokumente zyrtare për Zyrën e Kryetarit, për Kuvendin e Komunës, për drejtoritë, për njësitë dhe zyrat komunale etj.

Gjatë periudhës kohore Janar – Qershor 2020 kam lekturuar këto dokumente:

1. Informata vjetore e Kryetarit të Komunës me drejtorit komunale 2019.
2. Propozim plani i punës për komunitete. Rregulloren komunale për transparencë 2020; Informatë (DSHPE-ja, 10.06.2020).
3. Procesverbalet e Kuvendit Komunal, procesverbal XII-2019, Mbledhjen e jashtëzakonshme 07.05.2020, mbledhjen e III të Kuvendit 2020.
4. Procesverbalet e KPF-së, procesverbal XII-2019, mbledhja I dhe II 2020

Gjithashtu kam ndihmuar edhe gojarisht zyrtarët sipas ndonjë kërkesë me gojë që më është shtruar dhe kam kryer punë shtesë.

## Avokatit Publik të Komunës

Avokati publik i komunës, për periudhën për të cilën po raportojmë 01.01.2020 - 30.06.2020, kam pranuar nga gjykatat 14 lëndë, në përgjithësi të natyrave të ndryshme: civile, penale dhe lëndë të ndryshme.

Landë me padi civile kontesimore janë 7, penale janë 3, të ndryshme që kanë të bëjnë me gjetjen e megjave – sinorëve janë 3.

Për 7 lëndet me padi civile –kontesimore, me bazë juridike njohja e të drejtës së pronësisë në bazë të shpronësimit për interes nacional. Për këto lëndë kemi ushtruar 7 përgjigje në padi, të cilat presin për tu proceduar në shqyrtimet gjyqësore. Për 3 lëndët penale, 2 janë për uzurpime në pronësi publike, të cilat kanë filluar me kallzim penal, të cilat sipas detyrës zyrtare i udhëheq prokurori shtetëror, të cilat presin për tu proceduar në shqyrtimet gjyqësore. Për 3 lëndet e natyrës së ndryshme, që kanë të bëjnë me gjetjen e kufive, sinorve, megjave janë në procedurë.

Për këtë periudhë kemi edhe lëndë të bartura nga vitet paraprake, të cilat ende nuk janë përfunduar, sepse që nga 13 marsi 2020, 2 muaj e gjysmë, të gjitha institucionet nuk kanë punuar për shkak të pandemisë Covid 19, e

cila ka kapluar tërë globin tokësor. Kjo është arsyeja pse nuk kemi lëndë dhe pse nuk kemi të përfunduara apo s'paku të filluara në shqyrtim kryesor.

Të gjitha këto lëndë i takojnë periudhës janar, shkurt deri me 13 mars. Më tutje gjatë kësaj periudhe të raportimit nuk kemi, edhe pse kemi punuar me orar të shkurtuar, për shkak të pandemisë. Gjykatat nuk kanë treguar shqyrtime gjyqësore.

## **Zyra e projekteve**

Gjatë gjashtëmujorit janar-qershor 2020, kemi mbajtur mbledhjet e vazhdueshme në kuadër të diskutimit për listën e projekteve nga zyra e Kryetarit, Drejtorit të Financave dhe akteret e përfshirë në projekte dhe fillimi I punëve për projektet kapitale. Pastaj kryerja e punëve në bazë të vendimeve të caktuara, punët e percjellura nga viti paraprak, vazhdimi i projekteve, vizitat në teren.

Kemi pas mbledhjet e zakonshme të punës nga zyra e Kryetarit, Drejtorit të Financave, vazhdimi i punëve të projekteve dy vjeçare të bartura në këtë vit, nga gjysma e muajit punët nuk kanë vazhduar për arsye të pandemisë Covid 19, është vazhduar me punë nga shtëpia.

Nga muaji Prill, maj e qershor kemi vazhdimin e projekteve investive komunale mbledhjet e rregullta me zyrat e Kryetarit dhe Drejtorinë e Financave, vazhdimi i punëve të cilat kanë pasur mundësi të kryhen faza e projektimit, pranimet teknike të mbetura punimet e raporteve. Po ashtu vazhdimi i projekteve investive komunale faza e projektimit. Pas vendimit të ministrisë dhe lejimit të punëve në sektorin e ndërtimitarisë projektet kanë vazhduar në ekzekutim dhe vizitat në teren për projektet investive komunale.



# KAPITULLI III

## DREJTORIA PËR ADMINISTRATË

Misioni i Drejtorisë për Administratë është zbatimi i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, ligjeve tjera që aplikohen në Administratë, Udhëzimet Administrative të nivelit qendror, Statutit të Komunës së Vitisë dhe akteve tjera komunale të aprovuara nga Kuvendi i Komunës.

Në vazhdim do të paraqesim punën e sektorëve të kësaj drejtorie.

### I. Sektori për punë administrative

Sektori për punë administrative ka kryer punët dhe detyrat e punës për nevojat e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Kryetarit të Komunës, Këshillit të Drejtorëve dhe Drejtorit të Drejtorisë për Administratë. Ky sektor ka përgatit ftesat dhe materialet tjera për mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete, Këshillit të Drejtorëve, Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, etj. Kuvendi i Komunës ka mbajtur 4 seanca të rregullta dhe 2 seanca solemne, 2 të jashtëzakonshme, urgjente dhe 0 inauguruese. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 5 mbledhje të rregullta, Komiteti për komunitete ka mbajtur 5 mbledhje dhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajtur 2 mbledhje të rregullta. Kuvendi i komunës ka miratuar 1 rregullore, 1 plotësim-ndryshim të rregullores dhe 58 vendime të ndryshme. Të gjitha këto akte normative të Kuvendit janë përgatit për procedurë për nënshkrim dhe protokollim dhe janë dërguar në Ministrinë për Administrimin e Pushtetit Lokal për vlerësim të ligjshmërisë së këtyre akteve. Janë përgatit 9 procesverbale të seancave të Kuvendit të Komunës, 5 procesverbale të Komitetit për Politikë dhe Financa, 5 procesverbale të Komitetit për Komunitete, dhe 2 procesverbale të KKSBB.

Gjatë kësaj periudhe raportuese Këshilli i Drejtorëve ka mbajtur mbledhje konsultative javore dhe 5 mbledhje të rregullta ku janë shqyrtuar materialet të ndryshme të cilat janë përcjellë për shqyrtim dhe aprovim në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin Komunal. Për mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve është përgatit materiali si dhe janë hartuar procesverbale për këto mbledhje.

Për nevojat e Kryetarit të komunës për këtë periudhë raportuese janë hartuar gjithsejtë 297 dokumente: prej tyre 24 vendime, 2 Marrëveshje, kërkesa dhe shkresa të ndryshme. Vendimet e hartuara janë të natyrave të ndryshme: Propozim vendime për kuvend, të ndarjes së ndihmave financiare, vendime për formimin e komisioneve të ndryshme për pranimin e mallit, vendime për caktimin e menaxherit për mbikëqyrjen e punëve, vendime për pranimin teknik të punëve, etj.

Zyrtari për përkthim ka përkthyer në mënyrë simulante në të gjitha mbledhjet e Kuvendit, Komitetit për Politikë dhe Financa, Këshillit për Siguri në Bashkësi, Komitetit për Komunitete dhe Këshillin e Drejtorëve. Gjithashtu ka përkthyer edhe të gjitha materialet të cilat kanë dalë nga mbledhjet e Kuvendit, KPF, KKSBB, Komitetit për Komunitete dhe Këshilli i Drejtorëve.

### II. Sektori i gjendjes civile

Në vazhdim po e paraqesim numrin e dokumenteve të lëshuara nga Sektori i Gjendjes Civile për periudhën Janar – Qershor 2020.

Nr	Përshkrimi i Lëndëve	Totali
1	Ekstrakt Lindje	6316
2	Certifikata Lindjes	2889
3	Certifikata martesës	1509
4	Certifikata e Vdekjes	369

5	<b>Certifikata Vendbanimi</b>	<b>240</b>
6	<b>Certifikata e Bashkësisë familjare</b>	<b>1491</b>
7	<b>Certifikata e Statusit Martesor</b>	<b>246</b>
8	<b>Certifikata e Shtetësisë</b>	<b>135</b>
9	<b>Vërtetim nga Arkivi</b>	<b>255</b>
10	<b>Vendimet</b>	<b>70</b>
11	<b>Aktvdekjet</b>	<b>29</b>
12	<b>Vërtetim i Mjeteve</b>	<b>40</b>
13	<b>Vizita</b>	<b>1</b>
14	<b>Regjistrimet në LAL të jashtme</b>	<b>75</b>
15	<b>Regjistrimet në LAL të brendshme</b>	<b>63</b>
16	<b>Regjistrimet në LAV (vdekje të jashtme)</b>	<b>32</b>
17	<b>Regjistrimet në LAV (vdekje të brendshme)</b>	<b>19</b>
18	<b>Regjistrimet në LAM të jashtme</b>	<b>32</b>
19	<b>Kurorëzime të reja</b>	<b>143</b>
20	<b>Shkurorëzime</b>	<b>15</b>
21	<b>Humbje Shtetësie</b>	16
22	<b>Fitim shtetësie</b>	2
22	<b>Totali:</b>	<b>14017</b>

Numri i përgjithshëm dokumenteve të lëshuara për periudhën Janar – Qershor 2020, është **14017** dokumente. Numri i qytetarëve të cilët janë futur në sistemin e Gjendjes Civile në Komunën tonë është **53633**.

### III. Sektori i zyrës pritëse dhe arkivit

Numri i kërkesave të pranuar në zyrën pritëse është paraqit në formë tabelore:

Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Vdekurve -L.A.V nga jashtë	16
. Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Martuarve -L.A.M nga jashtë	27
Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Vdekurve LAV nga brenda	46
. Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Lindurve -L.A.L nga jashtë	75
Numri i kërkesave në zyrën pritëse si : LAL, LAM dhe LAV	
<b>TOTALI - 144</b>	
Deklaratat e nxjerra pran zyrës pritëse :	
Deklarata për vendqëndrim	24
Deklarata për trashëgimi	37
Deklarata për përkujdesje financiare	40
Deklaratë për regjistrimin të mëvonshëm në LAL	08
Deklarata për regjistrim në LAV	22
<b>Gjithsejtë: 107</b>	

## Lëndët e arkivuara

Drejtoritë	Nr. i lëndëve të arkivuara
Drejtoria për Shërbime Publike dhe emergjencë	64
Drejtoria për Administratë	8.483
Drejtoria për Arsim	566
Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	48
Drejtoria për Financa Ekonomi, dhe Zhvillim	2.197
Drejtoria për Kulturë , Rini dhe Sport	79
Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mjedisit	37
Drejtoria e Inspeksionit	31
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	268
Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër	1.464
Kuvendi i Komunës	05
Zyra e Kryetarit	635
Zyra për Komunitete	01
<b>Totali</b>	<b>13.878</b>

## IV. Sektori i administrimit

Në vazhdim po i prezantojmë shpenzimet e mirëmbajtjes, karburanteve dhe shpenzime tjera për automjete dhe gjeneratorë për periudhën Janar – Qershor 2020:

Shpenzimet e mirëmbajtjes së automjeteve dhe gjeneratorëve për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë për periudhën raportuese janë 9.172,00 euro.

- Administrata.....2688,00€,
- Shëndetësia .....4641,00€ dhe
- Njësia e zjarrfikëseve .....1843,00€

Shpenzimet për derivate të naftës për automjete, nxehe qendrore, gjenerator dhe autorizime për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë janë 26736 - litra.

Shpenzimet për derivate të naftës për automjete, për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë janë: 15.412 litra

- Administrata ..... 5122 litra,
- Shëndetësia .....5779 litra dhe
- Njësia e zjarrfikës .....4511 litra.

Shpenzimet për derivate të naftës për nxehe qendrore për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë janë 10013 litra naftë,

- Administrata .....10013 litra
- D. Kulturës .....00.00 litra
- Shëndetësia .....00.00 litra,
- Njësia e zjarrfikësve ..... 0 litra.

Shpenzimet për derivate të naftës për gjenerator për të gjitha njësit shpenzuese janë: 1311 litra.

- Administrata ..... 578 litra,
- Shëndetësia ..... 023 litra,
- Njësia e zjarrfikësve .....117 litra.
- Dka-ja (shkollat).....593 litra.

Zyra e IT-së ka udhëhequr dhe kontrolluar punën e sistemit të teknologjisë informative me qëllimin e zbatimit të standardeve dhe ofrimin e shërbimit më cilësor, në veçanti:

- Ka zbatua hardware, Softwerin kompjuterik dhe të qasjes me internet
- Mirëmbajtjen e infrastrukturës për internet dhe kyçje sipas nevojave të ndryshme për organet komunale.

Për periudhën janar – qershor 2020

Nr.	Emërtimi	Nr. Intervenimeve	Vërejtje
1	Risetimi password të Domenit	150	
2	Hapja e Userve të Domenit	15	
3	Hapja e Userave të Intranetit	2	
4	Intervenimet në Usera	95	
5	Intervenimet në rrjetin qeveritar	33	
6	Intervenimet në programe	150	
7	Konfigurimi i swiqit	6	
8	Intervenimet në Gjendjen Civile	50	
9	Intervenimet në Tatimin Pronë	15	
10	Futja e kompjuterëve në Domen	50	
11	Instalimi i software	80	
12	Instalimi i computer hardware devices	00	
13	Rregullimi kablllove të internetit	30	
14	Intervenimet në E-mail	100	
15	Hapja E-mail Zyrtar të reja për zyrtar Komunal	10	
16	Intervenimet në Intranet	55	
17	Monitorimi i Kuvendit përmes Teleprezencës	0	
18	Drejtoria Arsimit	15	
19	Qendra për punë sociale	10	
20	Telefonave VOIP	5	
21	Skanimi kompjuterëve nga viruset	00	
22	Intervenimet ne shtëpinë e Kulturës	00	
23	Asistimi ne rregullimin e fotokopjeve	50	
	<b>Gj i t h s e j t ë</b>	<b>841</b>	
<b>1. Mirëmbajtja e Serverit çdo ditë</b> <b>2. Mirëmbajtja e Intranetit çdo ditë</b> <b>3. Mirëmbajtja e Webfaqes çdo ditë</b> <b>4. Mirëmbajtja e Gjendjes Civile çdo ditë</b> <b>5. Mirëmbajtja e-pasurisë çdo ditë</b> <b>6.Sistemi për Menaxhimin dhe Arkivimin Elektronik të Dokumenteve çdo ditë</b>			

## **Zyrtari për pranimin e mallit**

- Pranimin dhe regjistrimin e mallrave ne Sistemin e menaxhimit te Pasurive (E-Pasuria), ku ne te përfshihen materialet shpenzuese si dhe asetet komunale ku vlera e këtyre materialëve është mbi **6.085.46€** apo diku mbi 28 lëndë;
- Kam plotësuar formularët për kërkesën e furnizimit me material për zyre dhe inventarë ne mbi 50 kërkesa;
- Kam bërë furnizimin me material shpenzuese si dhe inventarë për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë duke e përfshirë Zyrën e Kryetarit dhe të gjitha Drejtorit tjera dhe komunitetet;
- Kam asistuar në disa paramasa për furnizime me materiale shpenzuese për të gjitha njësit shpenzuese;
- Kam kryer edhe detyra tjera që më janë besuar nga menaxhmenti i Komunës.

## **DREJTORIA PËR FINANCA, EKONOMI DHE ZHVILLIM**

### **I. Sektori i Financave**

Gjatë kësaj periudhe janë kryer këto punë:

- Janë regjistruar 683 kupona të shpenzimeve në SIMFK ( sistemi i menaxhimit të financave të Kosovës) përmes transferit me procedurë të prokurimit dhe aprovimit në vlerë prej 1,079,112.55 euro;
- Janë çertifikuar 683 pagesa përmes transferit me procedurë të prokurimit dhe aprovimit në vlerë prej 1,079,112.55 euro;
- Gjatë kësaj periudhe në programin e Administratës Komunale dhe Arsimit parauniversitar janë dorëzuar në MAP – divizioni i pagave (punëtorë të ri , largime dhe ndryshime) ndryshimet, nga QKMF-ja kopje të pranuar të cilat janë përfshirë në evidencën e përgjithshme;
- Është bërë barazimi i të hyrave vetanake në baza mujore në mes të hyrave të arkëtuara dhe të hyrave të paguara;
- Janë pranuar, evidentuar ,protokolu 581 fatura , kontrata ,vendime dhe të njëjtat janë dorëzuar për zotim dhe vijim të procedurës të mëtejme deri te ekzekutimi;
- Janë pranuar 149 raporte nga drejtorit që inkasojnë të hyra vetanake në vlerë nën 10 euro dhe janë bërë 43 deponime në bankë.

### **II. Sektori i buxhetit dhe thesari**

Gjatë periudhës janar-qershor të vitit 2020 janë kryer këto punë:

- Regjistrimi i obligimeve të pa paguara për periudhën janar-dhjetor 2019;
- Përgatitja e pasqyrave financiare për periudhën janar-mars 2020;
- Sistemimi i të gjithë punëtorëve në sistemin e pagave nëpër të gjitha programet sipas planifikimit të buxhetit vitit 2020;
- Janë përgatit të gjitha deklaratat e disponueshmërisë së mjeteve për pagesë të projekteve duke u bazuar në planifikimin e buxhetit e vitit 2020;
- Dhënia e informacioneve për të gjithë udhëheqësit e programeve buxhetore mbi gjendjen e rrjedhjes së parasë së gatshme për tërë vitin 2020;
- Barazimi i regjistrave të pasurive mbi dhe nën 1.000 euro, të regjistruara në frebalanc/E pasuria si dhe regjistrimi në regjistra intern;
- Janë bërë zotimet e mjeteve për të gjitha programet buxhetore dhe kategoritë ekonomike varësisht nga kërkesat e autorizuesve të buxheteve përkatëse;
- Përpilimi i raportit të shpenzimeve për MF për TM-1 2020;

- Raportimi i obligimeve të pa kryera në MF ,në departamentin e thesarit për çdo muaj dhe është bërë përgatitja e pasqyrave financiare për TM-1 2020;
- Përgatitja e qarkores së parë interne komunale 2021/01.e datës 15.05.2020 për të zhvilluar procesin buxhetor komunal 2021-2023;
- Përgatitja e Kornizës Afatmesme të Buxhetit (KAB) komunal për vitin 2021-2023 të datës 16.06.2020;
- Konsultimi i vazhdueshëm me drejtorët e drejtorive rreth inicimit të shpenzimeve të ndryshme komunale.

### III. Sektori i Tatimit në Pronë

Gjatë periudhës janar-qershor të vitit 2020 janë kryer këto punë:

- Afrimi i shërbimeve për qytetarët e komunës për kryerjen e obligimit të tatimit në pronë;
- Afrimi i shërbimeve për qytetarët e komunës për pagesën e taksës komunale për automjete;
- Lidhja e marrëveshjeve me tatimpagues për pagesën e detyrimit tatimor sipas kushteve të parapara nga DFEZH dhe dhënia e këshillimeve palëve për kushtet e pagimit të tatimit në pronë;
- Gjatë periudhës janar-qershor të vitit 2020 janë shërbyer 4120 palë me vërtetime (struktura: 3050 vërtetime për regjistrim të automjeteve, 150 vërtetime për raste sociale dhe 1070 vërtetime për nevoja të katastrofit);
- Është kryer shpërndarja e mbi 11327 fakturave për çdo qytetar në Komunën e Vitisë;
- Gjatë periudhës janar- qershor të vitit 2020 janë inkasuar 105.421,18 euro nga tatimi në pronë dhe 31,460.0000 euro nga taksa komunale për automjete;
- Realizimi i planit për tatimin në prone shprehur në përqindje është realizuar 49.03 % kurse taksa komunale për automjete është realizuar 70.30%;
- Kemi përgatitur një plan të veprimit nga një komision kompetent për rritjen e shkallës së inkasimit të tatimit në pronë;
- Është përpiluar lista e borxheve të qytetarëve sipas fshatrave dhe paraqitja e përqindjes së realizimit të obligimeve për çdo lokalitet.

### IV. Sektori për ekonomi dhe zhvillim

Gjatë periudhës janar- qershor të vitit 2020 janë kryer këto punë:

- Kemi bërë dorëzimin e raportit të punës për vitin 2020 dhe planin e punës për vitin 2020;
- Kemi bere shqyrtimin e kërkesave të qytetareve për marrjen e pëlqimeve për shfrytëzimin e parcelave të Agjensionit Pyjore dhe të pronave nën menaxhimin e AKP-se;
- Kemi bere kërkesat pranë Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, për marrjen e lejeve të kërkuara nga Zyra e Projekteve.
- Me kërkesë të MTI-së, përkatësisht Divizioni I Turizmit, ne bëmë grumbullimin e informative, gjegjësisht bëmë identifikimin e produktit turistik për rajonin e Anamoravës-Komuna e Vitisë.

### V. Projektet e investimeve kapitale për vitin 2020 të financuara nga buxheti i Komunes së Vitisë dhe buxheti i nivelit qendror.

<b>1</b>	<b>Participimi i projekteve me donator në proces të realizimit</b>	<b>198.000,00</b>
<b>2</b>	<b>Asfaltimi i rrugëve rurale në proces të realizimit</b>	<b>280.000,00</b>
<b>3</b>	<b>Asfaltimi i rrugëve në fshatin Smirë, Kolishtë dhe Terpezë në proces të realizimit</b>	<b>189.150,00</b>

4	Rregullimi i kanalizimeve ne proces te realizimit	150.000,00
5	Rregullimi i rrugëve me zhavor ne proces te realizimit	110.000,00
6	Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik ne proces te realizimit	285.000,00
7	Rregullimi i hapësirave gjelbëruese – publike ne proces te realizimit	45.000,00
8	Rregullimi i fushave sportive ne proces te realizimit	83.000,00
9	Rregullimi i lumenjve (kanaleve) dhe prockave ne proces te realizimit	109,800.00
10	Zgjerimi i urave ne proces te realizimit	15.000,00
11	Fusha ndihmëse e futbollit ne Pozheran ne proces te realizimit	130.000,00
12	Riparime nëpër shkolla ne proces te realizimit	70.000,00
13	Renovim i ambulantave ne proces te realizimit	10.000,00
14	Furnizim me autoambulanc ne proces te realizimit	40.000,00
15	Ndërtimi i ambulantes në fshatin Terpezë në proces te realizimit	20.000,00
16	Rregullimi i sheshit ne Viti në proces te realizimit	220.951,25
17	Rregullimi i dy fushave sportive ne proces te realizimit	40.000,00
18	Rregullimi i rrugës Viti-Sllatinë në proces te realizimit	130.000,00
19	Renovimi i Shtëpisë se Kulturës ne Viti	22.500,00
20	Rregullimi i stadionit ne Pozheran	29.700,00
21	Rregullimi i gypit furnizues te ujësjellësit Viti - Letnice	24.000,00
22	Rregullimi i trotuareve (Verban, Ramnishte, Viti, Sedovinë e Muhaxhereve)	50.000,00
23	Asfaltimi i rrugëve rurale (Ramnishte, Begunc, Smire, Drobesh dhe Viti	52.500,00
24	Palestra e sporteve ne Drobesh (Punimi i konstruksioni te kulmit me kapriate)	85.000,00
25	Asfaltimi i rrugës Sedovin e Jerlive-Verban	54.886,00
26	Rregullimi i rrugëve me zhavor Smire, Drobesh	4.310,00
27		260.331,26

	<b>Renovimi dhe ndërtimin i infrastrukturës mbrojtëse përgjatë lumit Morava</b>	
<b>28</b>	<b>Renivimi i objekteve Komunale</b>	<b>23.405,58</b>
<b>29</b>	<b>Rregullimi i lumenjve dhe prrockave</b>	<b>28.977,00</b>
<b>30</b>	<b>Ndërtimi i infrastrukturës ne parkun industrial Budrike</b>	<b>671.292,57</b>
<b>31</b>	<b>Ndërtimi i stadionit ne Viti</b>	<b>60.738,00</b>
<b>32</b>	<b>Projekti i furnizimit me ujë (Stubell Eperme, Podgorc, Dobelldeh) CDI</b>	
<b>33</b>	<b>Furnizimi me ujë ne fshatin Letnice është përfunduar - CDI</b>	
<b>34</b>	<b>Është bere kyqja ne ujësjellës ne këto fshatra: Trestenik dhe Sedovinë e Çerkezeve - CDI</b>	
	<b>Gjithsej</b>	<b>3.493.541,66</b>

#### **VI. Zyra për regjistrimin e bizneseve**

- Gjatë periudhës janar- qershor 2020 janë regjistru 75 biznese të reja
- Gjatë kësaj periudhe janë shuar 9 biznese.
- Numri i përgjithshëm i të punësuarve është 80 punëtorë .

### **DREJTORIA PËR ARSIM**

Në Komunën e Vitisë procesi mësimor zhvillohet që nga çerdhet, parashkollorët, mësimi i ulët i mesëm dhe ai i lartë mesëm dhe ai i mesëm profesional. Gjatë kësaj periudhe deri më 11 mars 2020, mësimi është zhvilluar normalisht. Qeveria e Kosovës në përputhje me rekomandimet e IKPSH-së dhe ne bashkëpunim me MASHT-in marrin masa përkatëse me rastin e shfaqjes së rasteve të para të Covid 19 në Kosovë. Sipas udhëzimeve të lëshuara nga Qeveria e Kosovës dhe MASHT kanë pezulluar mësimin e rregullt dhe njëkohësisht brenda javës kanë dalë me vendim që procesi mësimor online të fillojë më 23 mars në distancë përmes Televizionit publik RTK i cili vazhdoi sipas kalendarit shkollor 2019/2010 për ciklin e shkollës së mesme të ulët pra klasat 1-9. Kjo gjë ka ndodhur njësoj si edhe në komunat e tjera në Kosovë. Ne kemi filluar me kohë planin e veprimit për aktivizim të shkollave për fillimin e mësimin online përmes platformave të ndryshme sidomos atyre të propozuara nga MASHT-i. Që nga evidentimi i rasteve pozitive me virusin Covid 19, të gjitha aktivitetet e punës kanë kaluar online, me anë të platformave si ZOOM, Google Meet, WhatsApp, Viber, Facebook dhe shumë të tjera me qëllim që të mbahet kontakti virtual mësimdhënës-nxënës etj, duke përfshirë edhe:

- Ligjëratat me nxënës, përcaktimi i orarit mësimor shkollor, raportimet pas ligjëratave në TV;
- Ligjëratat ku në fokus kanë qenë temat për menaxhimin e kohës në izolim, menaxhimin e ankthit, depresionit, stresit etj nga ana e psikologëve shkollorë;
- Seanca me nxënës me nevoja të veçanta dhe me prindër për shqyrtime dhe ankesa për organizim më të mirë të mësimin;



- Me mësimdhënës për trajnime teknologjike që janë organizuar nga ana e DKA-së dhe grupe të mësimdhënësve;
- Zhvillimi i takimeve online me MASHT-in;
- Trajnime me organizata të ndryshme;
- Mbajtaja e kontakteve ne mes të DKA-së dhe MASHT-it;
- Raportimet dhe takime e rregullta me drejtorët e shkollave dhe DKA;
- Raportimet e rregullta të DKA–MASHT dhe Inspektoratit arsimor.

#### 1. Mësimi ne distancë

- Pas vendimit të qeverisë për ndërprerjen e mësimin për shkak të pandemisë, DKA-ja në bazë të udhëzimeve të MASHT-it ka organizuar mësimin online në të gjitha shkollat duke filluar në disa shkolla me herët se sa vendimet e Masht-it;
- Janë kontrolluar të gjitha shkollat në aspektin profesional pedagogjik si dhe i gjithë dokumentacioni i nevojshëm;
- DKA-ja ka bërë parapërgatitjet për Testin e Arritshmërisë për klasat e IX-ta dhe për Testin e Maturës Shtetërore për klasat e XII;
- Kemi dërguar në MASHT, shënimet statistikore përmes Sistemit të SMIA-së, për nr. e nxënësve sipas paraleleve në secilën shkollë, numri i personelit arsimor etj;
- DKA-ja, ka shtuar aktivitetet për ngritjen e interesimit të nxënësve për testet e Arritshmërisë dhe Maturës Shtetërore, duke i njoftuar nxënësit për mënyrën e plotësimit të testit, për fushat e dijes në cilat do të testohen etj;
- Po ashtu arsimtarët e fushave të ndryshme, me qëllim të ngritjes së tyre profesionale kanë marrë pjesë në trajnime, seminare, debate etj;
- Janë mbajtur debate ,konsulta për tema të ndryshme rreth dukurive negative të nxënësve nëpër shkolla;
- Në mënyrë të rregullt kemi përcjell procesin mësimor në vazhdimësi;
- Është bërë dezinfektimi i të gjitha objekteve shkollore.

#### 2. Përfundimi i vitit shkollor

- Komuna e Vitisë me gjithsejtë 17 shkolla filllore te mesme të ulëta si dhe 18 paralele të ndara, 3 shkolla të mesme të larta e dy çerdhe për fëmijë, njëra private ka gjithsejtë 8123 nxënës duke përfshirë edhe çerdhet;
- Me vendim të MASHT-it mësimi ka filluar në distancë TV më 23 mars si dhe online përmes platformave digjitale nëpër shkolla dhe disa shkolla edhe më herët se kjo datë në komunën e Vitisë dhe është realizuar plani pothuajse në tërësi;
- DKA-ja ka organizuar mësimin në distancë si dhe online në të gjitha shkollat e komunës së Vitisë duke përfshirë të gjithë nxënësit me rreth 93% e nxënësve që janë përfshirë në mësimin online;
- Viti shkollor 2019/20 apo gjysmë-vjetori dytë, periudha e tretë është përfunduar në të gjitha shkollat me data të parapara nga kalendari i MASHT-i për këtë vit shkollor, të gjithë nxënësit janë notuar, raportet e mësimdhënësve janë dorëzuar në shkollat ku punojnë dhe të gjitha punët janë kryer duke ju përmbajtur udhëzimeve administrative të nxjerra nga MASHT-i për organizimin e mësimin online, në distancë, si dhe për përfundimin e vitit shkollor 2019/20.

### 3. Aktivitetet në shkolla të ndryshme gjatë periudhës janar-qershor 2020

Lloji i aktivitetit	Shkolla	Vërejtje
Garë e diturisë për Ditën e Pavarësisë “17 shkurt”	Shfmu “Nijazi Rexhepi” Sllatinë	Garë brenda/shkollore
Projekti me i mire në fushën e kodimit-organizuar nga British Council/ Projekti “Shkollat e shekullit 21” Vendi i parë	Shfmu “Dëshmoret e Vitisë” -Viti	11 mars
ASSET dhe me partneritet IPKO-n organizuan “Sfidën e dizajnit 2020”, ku 22 shkolla dorëzuan 55 projekte, dhe nxënësit e gjimnazit morën dy çmime.	Gjimnazi “Kuvendi i Lezhës” Viti	21 prill
U realizua dhe u mbajt “Panairi Inovativ 2020” me punime të nxënësve në fushën e elektronikës, Më pas do të marrin pjesë në gara në nivel vendi.	Shkolla e Mesme Teknike Profesionale “Jonuz Zejnullahu” Viti	5 mars
U organizua finalja e futbollit të vogël për nder të ditës së mësuesit “7 Mars” ku fitues doli shkolla Sh.m.t.p.“Jonuz Zejnullahu”	Shkolla e Mesme Teknike Profesionale “Jonuz Zejnullahu” Viti	6 mars
Pjesëmarrje ne gara të Esesë ne nivel Republikan. Tema ”Përzgjedhja e karrierës-sfidat dhe mundësitë” Vendi i parë për esenë më të mirë.	Gjimnazi “Kuvendi i Lezhës” Viti	Maj 2020.
Orë e madhe letrare- organizuar nga Shoqata e shkrimtarëve të Komunës së Vitisë me nxënësit e shkollës!	Shfmu “Skender Emërllahu” Ramjan	13 shkurt.
Dita e shkollës dhe përrurimi i bibliotekës së financuar nga Korpusi Amerikan i Paqes, në vlerë prej 3500 eurosh.	Shfmu “Skender Emërllahu” Ramjan	11 mars
U shënuar dita e mjedisit, ku mësimmshënësit me disa nxënës rregulluan dhe vendosën disa dizajne brenda ambientit shkollor si mesazh vetëdijesimi	Shfmu “Dëshmoret e Vitisë” Viti	5 qershor
Gara e diturisë për nder të ditës së mësuesit në lëndën e Kimisë, brenda klasave në shkollë.	Shfmu “ Dëshmorët e 5 prillit” Smirë.	7 mars
Vendi i tretë për nivelin 1-5 në nivel republikan në garat e Robotikës KML.	Shfmu “Dëshmoret e Vitisë” Viti	Qershor 2020
“Dhëmbët kërkojnë kujdes”, kontroll e dhëmbëve me nxënësit e klasave të katërta, ofruar nga QKMF Viti.	Shfmu “Halil Alidema” Pozheran	26.Mars
Garë për esenë më të mirë shkollore për nder të ditës së mësuesit	Shfmu “Halil Alidema” Pozheran	8 mars
U shënuar dita e tokës përmes punimeve të nxënësve dhe dita botërore e librit	Shfmu “Halil Alidema” Pozheran	22 prill dhe 23 prill

Orë e madhe letrare të organizuar nga shkolla dhe Unioni i Shkrimtarëve shqiptarëve me drejtor Reshat Sahitaj, ku 3 nxënës të kësaj shkolle u vlerësuan për esenë më të mirë për të vazhduar tutje në nivel vendi.	Gjimnazi “Kuvendi i Lezhës” Viti	Mars
Më 7 mars DKA në bashkëpunim m sindikatën e arsimit organizuan mbrëmje festive dhe darkë për mësimdhënësit e komunës së Vitisë , me ç’rast u shpërndanë edhe mirënjohje për mësimdhënësit e dalluar për 2019/2020. Për të gjithë mësimdhënësit DKA ka dhuruar dhurata modeste për të gjithë mësimdhënësit/		7 mars
Ligjërata dhe debate virtuale përmes platformës ZOOM ndërmjet LMT-Trupave të KFOR-it amerikan ne kampin Bondsteel me nxënës dhe klasa të ndryshme dhe me tema aktuale në shumë shkolla të Vitisë të organizuar nga DKA dhe disa mësimdhënës të gjuhës angleze në shkollat fillore të mesme të ulëta.	“Dëshmorët e Vitisë” “Skënder Emerllahu” “Dëshmorët e Lubishtës” dhe “Halil Alidema”	24 prill deri 24 qershor

#### 4. Shërbimi psikologjik

- Është bërë evidentimi i rasteve (nxënësve), të cilët kanë nevojë për shërbim psikologjik;
- Vazhdim i psikoedukimit me nxënës, duke përfshirë fusha të ndryshme;
- Administrimi i testeve psikologjike, duke përfshirë ata të inteligjencës, personalitetit, organicitetit etj.(HTP test, Mini School test, Unit test, Bender Gestalt test 1, Bender Gestalt 2, Kohchs test, Raven test, Vineland scale, EPI test, MMPI 201 test etj);
- Mbajtja e seancave psikoterapeutike. Nxënësit janë trajtuar me: Këshillim psikologjik, teknika biheviore, psikoterapi pozitive, psikoterapi trupore, psikoterapi familjare pozitive;
- Punë e vazhdueshme tek klasa e bashkëngjitur me nxënësit me nevoja të veçanta;
- Takime me ekipen për parandalimin dhe braktisjen e shkollës;
- Takime me ekipen për vlerësim pedagogjik të nxënësve;
- Bashkëpunim me QPS-në;
- Vizita nëpër shkolla;
- Prezentim në takime dhe punëtori;
- Takime në MASHT;
- Shpërndarja e certifikatave të kurrikulës për mësimdhënës.

#### 5. Zyra ligjore e DKA-së në Viti (Sekretaria)

- Në periudhën janar-qershor janë protokolluar 344 lëndë të natyrave të ndryshme: Vendime të çështjeve të ndryshme, kontrata, konkurse, përgjigje në padi për gjykatën, njoftime, përgjigje në kërkesa, ankesa, vërtetime, pëlqime si dhe shkresa tjera;
- Kemi përfaqësuar DKA-në, në Gjykatën Themelore Dega në Viti, në kërkesëpaditë të ushtruara nga personeli arsimor dhe palët;

- Për këtë periudhë kohore kemi shpallur 2 konkurse publike për punëtor arsimor dhe janë pranuar gjithsejtë 13 punëtor arsimor;
- Me kohë kemi shpallur konkurset publike për kuadër arsimor për vendet e lira të punës dhe ndryshimet i kemi bërë me kohë në fillim të ç' do muaji;
- Kemi bërë një planifikim të mirë, pasi që të gjithë punëtorët arsimor janë të pajisur me kontrata të punës dhe të gjithë të punësuarit në Sektorin e arsimit janë të futur në Sistemin e pagave;
- Me rastin e regrutimit- pranimit të personelit arsimor kemi zbatuar normativin në fuqi, duke filluar nga Ligji i arsimit, udhëzimin administrativ të MPMS dhe aktet tjera nënligjore;
- Me rastin e pranimit të personelit arsimor, nuk kemi asnjë rast ku kemi bërë shkelje ligjore apo shkelje e të drejtave të aplikantëve, sepse nuk kemi lejuar të anashkalohej kualifikimi, përvoja e punës apo rezultatet e testit me shkrim dhe me gojë, për këtë që po e themi ekzistojnë faktet dhe dokumentacioni në DKA;
- Po ashtu kemi edhe konfirmimin nga Inspektorati Regjional i Punës për rregullaritetin e rekrutimit dhe pranimit të mësimdhënësve dhe të gjitha ankesat e palëve të pakënaqura janë refuzuar;
- Gjatë punës ky sektor gjithmonë ka parasysh parimin e efikasitetit në punë, me rastin e shqyrtimit të kërkesave, ankesave dhe veprimeve tjera procedurale duke respektuar afatet ligjore dhe zyrtare.
- Me kohë i kemi pajisur punëtorët arsimor me kontrata të punës (aktemërim);
- Jemi duke i bërë parapërgatitjet për shpalljen e Konkursit të rregullt publik për mësimdhënës për vitin shkollor 2020/21, në planifikimin e pozitave të lira duke kërkuar nga drejtorët e shkollave informata për pozitat e lira.

#### 6. Sektori i financave

- Pagesa e obligimeve nga viti 2020;
- Ndryshime në listat e pagave ku përfshihen: largime nga listat, punëtor të rinj, ndryshime (ndërrim institucioni, ndalesë mjekësore dhe e lehonisë, ndalesë për mungesa etj), pagesa retroaktive, ndërrim llogarisë bankare etj;
- Përgatitja e paramases (nga kërkesat e shkollave) për Furnizim me dru zjarri për vitin shkollor 2020-21;
- Furnizime me tonera letër dhe material hargjues;
- Përgatitja e kornizës afatmesme të shpenzimeve;
- Pranimi shpërndarja dhe kompletimi me nënshkrime i listave të pagave;
- Inicimi i kërkesave për shpallje të tenderëve për nevojat e shkollave;
- Organizimi i transportit të nxënësve për nxënësit e fshatrave Letnicë dhe Podgorc;
- Organizimi i transportit të nxënësve me nevoja të veçanta për në shkollën special në Prizren;
- Pagesat e shërbimeve komunale;
- Përgatitja e lëndëve për pagesa dhe furnizime;
- Janë furnizuar të gjitha shkollat me rekuizita sportive;
- Janë furnizuar shkollat me laptopë si dhe një laptop në DKA;
- Janë furnizuar të gjitha shkollat me materiale të imëta;
- Zyrtarja e depos e pranimit në freebalance ka kaluar lëndë për drejtorinë e arsimit, po ashtu edhe për gjithë komunën, te gjitha këto lëndë kapin shifrën rreth 500 lëndë te cilat janë përfunduar për këtë periudhë gjashtë mujore.

## 7. Donacionet

Donacioni	Shkollat përfituese	Data
Një prind i dhuron shkollës për paralelen e ndarë në Terstenik një tavolinë pingpongu , raketa dhe topa.	Shfmu “Nijazi Rexhepi” Sllatinë e epërme	Shkurt 2020
Printer me ngjyra nga fondacioni BONEVET KML	Shfmu “Dëshmoret e Vitisë” Viti	Prishtine
Është fituar granti nga Banka Botërore në vlerë prej 13.300 Euro për modernizimin e shkollës me mjete konkretizuese.	Shfmu “Dëshmoret e Vitisë” Viti	28 prill
Organizata zvicerane “Helvetas” me participim të KK Viti në shumë prej 11.000 euro ndihmuan shkollën në funksionalizimin e qendrës së karrierës duke e mobiluar dhe ofruar mundësi pune.	Shkolla e mesme teknike profesionale “Jonuz Zejnullahu” Viti	26 maj 2020
Studentë francezë të shoqatës” <b>Help Kosova</b> ”kanë ndihmuar shkollën me çanta dhe materiale të ndryshme shkollore.	Shfmu “Dëshmorët e Lubishtës”, paralelja në Buzovik	5 mars
Përfitues të projektit “FRED”/Këshilli Europës , kursi i gjuhës turke për 60 nxënës.	Sh.f.m.u ”Halil Alidema” Pozheran	6 shkurt
U be hapja e puseve si donacion nga HUMAN APPEAL INTERNATIONAL, shoqatë nga Emiratet e Bashkuara Arabe në katër shkolla të komunës së Vitisë.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjimnazi “Kuvendi i Lezhës”</li> <li>• Shfmu “Nijazi Rexhepi” Sllatine e epërme</li> <li>• Shfmu “Safet Rexhepi Zhiti/Ballancë</li> <li>• Shfmu “Nazmi Pajaziti” Radivojc.</li> </ul>	Qershor 2020
ELKOS group, dhuroi 11 laptop për nxënësit në nevojë gjatë mësimin në distancë	Viti	7 maj /Prishtinë

## 9. Shkollat fillore të mesme dhe të larta

Nr.	Emri i shkollës	Vendi	Nr. i nxënësve	Nr. i klasave	Nr. i mësim dhënësve	Nr. punëtorëve teknik	Nr. Administratës
1	"Dëshmorët e Vitisë"	Viti	682	28	37	3	2
	Paralele e ndare	Drobesh	166	8	8	1	
2	"Bafti Haxhiu"	Viti	693	30	38	5	2
	Paralele e ndare	Ramnisht	176	10	8	1	
3	"Njazi Rexhepi"	Sllatinë	247	15	22	3	2

	Paralele e ndare	Sllatinë e poshtme	122	10	11	1	0
	Paralele e ndare	Lagje e Gjinolleve	152	10	11	1	0
	Paralele e ndare	Trestenik	81	10	11	1	0
	Paralele e ndare	Sodovine e muhaxherve	140	6	6	1	0
4	"Halil Alidema"	Pozheran	477	30	38	3	2
	Paralele e ndare	Qifllak	2	1	1	1	
5	"28 Nëntori"	Vërban	284	19	27	2	
	Paralele e ndare	Sodovinë	163	10	8	1	
6	"Dëshmorët e 5 prillit"	Smirë	406	24	32	4	
7	"Ndre Mjeda"	Kabash	265	17	23	3	
	Paralele e ndare	Debulldeh	22	9	11	1	0
	Paralele e ndare	Binqë	12	3	3	1	0
8	"Kenan Halimi"	Skifteraj	263	20	28	2	
9	"Nazmi Pajaziti"	Radivojc	218	12	21	2	
	Paralele e ndare	Budrikë	84	10	10	1	0
	Paralele e ndare	Devajë	14	5	3	1	0
10	"Dëshmorët e Lubishtës"	Lubishtë	186	14	21	2	
	Paralele e ndare	Buzovikë	71	9	11	1	0
	Paralele e ndare	Podgorc	18	4	3	1	0
11	"Hysen Terpeza"	Terpezë	235	18	23	2	
12	"Hasan Alia"	Remnik	198	14	17	2	
13	"Skender Emerllahu"	Ramjan	179	17	18	2	
	Paralele e ndare	Fshati i ri	60		-	-	-
14	"Mirali Sejdiu"	Goshicë	105	10	17	2	
	Paralele e ndare	Gërmovë	105	10	6	2	
15	"Ahmet Hajdari"	Beguncë	145	11	<u>15</u>	<u>2</u>	
16	"Safet Rexhepi"	Zhiti	78	9	19	1	
	Paralele e ndare	Ballancë	70	8		1	
17	"Dom Mikel Tarabulluzi"	Stubëll	105	13	17	2	
	Paralele e ndare	Letnicë	12		-	-	-
	<b>Çerdhe</b>				-	-	-
1	"Gëzimi Ynë"	Viti	100	4	<u>8</u>	<u>5</u>	
	<b>Shkollat e mesme të larta</b>				-	-	-

1	"Kuvendi i Lezhës"	Viti	814	39	59	5	3
2	"Januz Zejnullahu"	Viti	579	44	70	5	2
3	"Kongresi i Manastirit"	Pozheran	240	17	<u>23</u>	<u>2</u>	1
	Gjithsej		7969	528	684	76	32

## 10. Investime kapitale

- Fillimi i procedurave në tenderim për renovimin e shkollave në nevojë;
- Fillimi i punimeve në shfmu "Safet Rexhepi| në Zhiti dhe në shfmu "Nijazi Rexhepi" në Sllatinën e ulët për eficiencë të energjisë ku parashihet izolimi i shkollës, kulmi dhe instalimi i ngrohjes qendrore. Ndërsa për shkollat tjera do të fillojnë planifikimet në gjashtëmujorin e ardhshëm;
- Nënshkrimi i marrëveshjes me Ministrinë e Arsimit për revitalizimin e shkollës së Çifllakut me vendim të Kuvendit për shndërrim në çerdhe, i cili është investim i përbashkët Ministri-Komunë dhe procedurat e tenderimit kanë filluar;
- Vazhdimi i punimeve në shfmu "Dëshmorët e Vitisë", paralelja në Drobesh. Investim i MASHT-it dhe vazhdimi i punimeve edhe në shfmu "Halil Alidema", investues MASHT-i;
- Zhvillimi i procedurave të tenderimit për projektin dy vjeçar për fusha sportive. Për disa fusha vetëm me rrethoja, fusha të reja dhe disa fusha sportive me gomë në disa shkolla të komunës së Vitisë.

## 11. Sfidat e paraqitura

- Sfidë kryesore ka qenë luftimi më pandeminë dhe organizimi i mësimit në distancë;
- Kushtet e vështirësuar në punë nga vjetërsia dhe dëmtimi i objektit të DKA-së;
- Mungesa e hapësirës së mjaftueshme për punë;
- Zvogëlimi i numrit të nxënësve;
- Mungesa e pajisjeve teknologjike për zhvillimin e mësimit në distancë për një numër të nxënësve;
- Transferimi në zyre e reja në muajin qershor në zyrat e ish komunës së vjetër, ku hapësira për punëtorët është më e përshtatshme për zhvillimin normal të punës.

## DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

### I-Zyra e Drejtorit të DSHMS-së

Zyra e Drejtorit të DSHMS-së përbehet nga Drejtori, juristi dhe punëtori i administratës. Punët të cilat janë kryer nga stafi i drejtpërdrejtë i drejtorit janë paraqitur në tabelën si në vijim me të dhënat konkrete të punëve, si ndarja e subvencioneve për ndihmë momentale të cilat janë aprovuar nga komisioni në përbërje të tre anëtarëve pastaj edhe ato të cilat janë pranuar, të proceduar dhe të aprovuara, si dhe ato që janë refuzuar dhe janë nën pezullim. Drejtoria e e DSHMS-së gjatë periudhës gjashtëmujore është përballur edhe me pandeminë Covid-19. Gjatë kësaj kohe përveç detyrave normale të zyrës ka pasur qëllim edhe luftimin e pandemisë si dhe në organizimin me përballje me sfida të cilat janë paraqitur gjatë kësaj periudhe emergjente.

- **Përcjellja e politikave në shëndetësi dhe mirëqenie sociale**

Vizitat e shpeshta dhe kontaktimi me punëtorë si dhe me stafin udhëheqës të njësive punuese QKMF DHE QPS, të cilat janë bërë me qëllim të bashkëpunimit dhe të identifikimit të problemeve për një menaxhim sa më efikas. Vizitat e tilla të koordinuara kanë dhënë rezultate të dukshme në afrimin dhe komunikimin ndër-institucional në mes këtyre dy njësive punuese.

- **Takimi i stafit për promovim të punës ekipore.**

Takimet të shpeshta brenda javës janë mbajtur në secilën njësi punuese me ekipin udhëheqës me qëllim të hartimit të strategjive për punë ekipore dhe vendosjen e një plani të detajuar.

**Projekte kapitale.**

1. Përrurimi i QMF-së në Sllatinën e Epërme.
2. Udhëheqja e procedurave të prokurimit për furnizimin me autoambulancë.
3. Udhëheqja e procedurave të prokurimit për renovimin e QKMF-së

**Marrëveshje Bashkëpunimi**

1. Vazhdimësi bashkëpunimi mbi asgjësimin e mbetjeve medicinale në marrëveshje me Spitalin Regjional të Gjilanit.
2. Marrëveshje me Institutin Regjional të Shëndetësisë Publike në Gjilan për kontrollimin e ujit të pijshëm nëpër vendet rurale si dhe në objektet institucionale dhe ato për qytetarë në vende publike.
3. Vazhdon kontrata dypalëshe në mes të komunës së Vitisë dhe KARITAS Kosova për ofrim të shërbimeve mjekësore nëpër familje ku paraqitet nevoja për ndihmë

<b>Pasqyra totale e kërkesave në DSHMS-Janar-Qershor 2020</b>						
<b>Lloji i kërkesës</b>	<b>Pranuar</b>	<b>Aprovuar</b>	<b>Refuzuar</b>	<b>Procedurë</b>	<b>Ceduar</b>	<b>Shuma</b>
Kërkesa për ndihma momentale	<b>61</b>	<b>12</b>	<b>38</b>	<b>11</b>		<b>1,800.00 €</b>
Kërkesa për punësim pranë DSHMS- QKMF-së	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	
,Kërkesa për Praktikë	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	
Kërkesa-shkresa te ndryshme	<b>10</b>	<b>10</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	
Gjithsej	<b>71</b>	<b>22</b>	<b>38</b>	<b>11</b>	<b>0</b>	

mjekësore.

**Donacione**

1. **Made Kos**, Terapi dhe pajisje mbrojtëse në vlerë 4560 euro.
2. 16.03.2020 **Biolabi –Gjilan**-Aparat oksigjeni dhe 100 lanceta për marrje gjaku.
3. 18.03.2020 **Dr.UkeBerisha** 100 veshje mbrojtëse.
4. 24.03.2020 **Indoli Pharm**-Maska higjienike 100, Baby system 23 g, 500, Dorëza 5 complete.
5. **LabinotTahiri**-Maska mbrojtëse 1800 copë.
6. **Stubllatex**-10 palë rroba mbrojtëse.



7. **Spitex** 500 maska.
8. Klubi **Rotarian “Vitia”**, ka dhuruar 20 palë veshje mbrojtëse dhe 40 mbrojtëse për fytyrë, me date 09.04.2020.
9. Argjendaria **“Adelina”** ka dhënë donacion dezinfektues dhe maska në vlerë 500 euro.
10. **”Koha DM”**, ka dhënë donacion 10l dezinfektues dhe 2000 doreza kirurgjike.
11. **Dr.Nazim Dauti**, radiolog,dhuroi 50 dezinfektues për duar, datë 14.04.2020.
12. **Mobileria As** -Sadat Rexhepi nga Ramjani dhuroi 70 maska mbrojtëse (prodhim vendor)
13. **Balkan Petrol** – Me date 15.04.2020 dhuroi donacion 200 l alkool, 2000 dorëza një përdorimesh, 20 veshje mbrojtëse një përdorimesh, 100 maska mbrojtëse.
14. Me 20.04.2020 kompania **“Ekologjia“ nga Ferizaji** ka dhënë donacion një TUNEL DEZINFEKTUES për QKMF-në në Viti.
15. Më 21.04.2020 kompania **“Plastal“** me pronar **Sabit Beqiri** nga Verbani i Vitisë ka dhënë donacion një TUNEL DEZINFEKTUES për QMF-në në Pozheran.
16. Më 23 .04.2020 **Kolegjiumi i Sindikatës së Shëndetësisë në Gjakove**, në koordinim me Kompaninë **“ BONEVET “** ka dhuruar një donacion prej 80 mbrojtëseve për fytyrë për punëtorët shëndetësorë të QKMF-së në Viti.
17. Më 23.04.2020 Kompania **“Galeni Group”** nga Vitia, me pronar Abdurrahman Xhela ka dhuruar 1500 maska mbrojtëse për QKMF-në në Viti.
18. Më 24.04.2020 **Këshilli i Bashkësisë Islame në Viti** ka dhuruar 10 pako ushqimore për punëtorët shëndetësor të QKMF-se në Viti .
19. Më 27.04.2020 qytetari **Shaip Deda, nga Remniku i Vitise**, i cili jeton në France, ka dhuruar pajisje mbrojtëse për punëtorët e QKMF-se në Viti, zjarrfikësit dhe policinë në vlerë prej 1000 euro.
19. Më 28.04.2020 qytetari **Xhavit Islami nga Gjeneva** ka dhuruar 50 palë veshje mbrojtëse për punëtorët e QKMF-së në vlerë prej 1000 frangash.
20. Më 29.04.2020 qytetari **Sokol Shaqiri nga Tërpeza e Vitise**, i cili jeton në Gjeneve ka dhuruar pajisje mjekësore për mjekët e QKMF-se në vlerë prej 1000 euro.
21. Më 29.04.2020 **“ICT Academy”** me pronar Atdhe Buja ka dhuruar 30 mbrojtëse për fytyrë për punëtorët shëndetësor të QKMF-së në Viti
22. Më 30.04.2020 **Mobileria “Mob King”** me pronar Driton Demelezi nga Sllatina e Ulët ka dhuruar 120 maska,60 kapela dhe 5 përparëse për personelin shëndetësor të QKMF-së në Viti.
23. **Zjarrfikësit e Vitisë** në vazhdimësi kanë bërë klorifikimin e ambientit të QKMF-se në Viti.

#### Promovimi i shëndetit

- Më 4 shkurt është shënuar dita botërore në luftën kundër kancerit, organizuar nga QKMF në Viti.

#### II-QKMF –Viti me njësitë e saja në territorin e Komunës së Vitisë

Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare bëhet ofrimi i shërbimeve mjekësore për qytetarë sipas këtyre kategorive mjekësore:

**1.Shërbimet primare:** Mjekësia familjare; Stomatologjia; Imunizimi; Emergjencia; Diagnostika (Laboratori dhe Shërbimi Radiologjik)

**2. Shërbimet specialistike**

a. Pediatria

c. Shërbimi i sëmundjeve të brendshme (Internisti)

- Në QKMF në qytetin e Vitisë punohet 24-orë. Të gjitha shërbimet mjekësore familjare, stomatologjike, pediatrike, interne, radiologjike dhe laboratorike kryhen vetëm gjatë ndërrimit të parë të orarit të punës. Vlen të theksohet se shërbimet laboratorike në periudhë tremujore nuk janë dhënë shërbime të plota, për shkak të vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë gjatë masave të marra për mbrojtjen e stafit shëndetësor ndaj Covid-19, gjithashtu gjatë kësaj periudhe është punuar me staf shëndetësor të reduktuar. Qendra e emergjencës punon gjatë 24 orëve për çdo ditë të javës.
- Gjatë këtij gjashtëmujori, puna në QKMF ka qenë me sfida të mëdha për stafin shëndetësor pasi që në çdo moment kanë qenë të rrezikuar që nga 13 marsi kur për herë të parë është paraqitur pacienti zero. Në QKMF, në repartin e emergjencës është identifikuar si pacienti i parë në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, prej 13 marsit jemi detyruar që t'i vet-izolojmë 17 shërbyes shëndetësorë për 15 ditë, të cilët ishin në kontakt me pacientin e identifikuar me Covid-19, mostrat e të cilëve për fat të mirë rezultuan negativë. Ne tabel mund të shofim numrin e personave të prekur nga Covid-19

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Rastet e testuar për COVID19 në Komunën e Vitisë prej 13.03.2020 deri 30.06.2020</b></li> </ul>	
<b>Komuna e Vitisë</b>	<b>Sipas vendbanimeve</b>	<b>Nr. TOTAL</b>
<b>Testime në komunën e Vitisë</b>		<b>353</b>
<b>Raste Pozitive</b>	<b>1.Stublla e epërme (12), Pozharan (12), Ramjan (12), Gjylekar (27), Smirë (5), Viti (14), Gushicë (3), Zhiti (8), VERBAN (2), BEGUNCË (6), Sllatinë e Eperme(3), Remnik (1), Sllatinë e Poshtme(2), Tërstenik (2),Kabash(3)</b>	<b>115</b>
<b>Rastet nga faza e dyte</b>	<b>Zhiti (8), Beguncë (6), Viti (3), Kabash(4), VERBAN (3), Sllatinë e Epërme(3), Remnik (1), Sllatinë e Poshtme(2), Tërstenik (3),Gjylekar(21), Pozharan (6), Smire (2)</b>	<b>62</b>
<b>Raste negative</b>		<b>238</b>
<b>Raste të shëruara</b>	<b>Stubëll (12), Smire (3), Gjylekar (12), Viti (11),Gushicë(3),Ramjan (12),Pozharan (9), Zhiti (8), VERBAN (2), BEGUNCË (6), Sllatine e Eperme (2) , Remnik(1)</b>	<b>81</b>
<b>Raste aktive</b>	<b>Gjylekar (15), Sllatinë e Poshtme(2), Tërstenik (3),Sllatinë e Eperme(1), Viti (3),Kabash (4),Pozheran (3),Smire (1), Verban (1)</b>	<b>32</b>

<i>Raste të hospitalizuar</i>	<i>Gjylekar (2), Sllatinë e Poshtme(1), Tërstenik (3),Sllatinë e Epërme(1), Viti (1)Kabash (1), Pozheran(1), Verban (1)</i>	<i>11</i>
<i>Persona të izoluar</i>		<i>32</i>
<i>Të vdekur</i>	<i>Gjylekar</i>	<i>1</i>

- **QMF-të si dhe AMF-të të cilat kanë funksionuar gjatë kësaj periudhe në komunën e Vitisë**

- 1.QMF-Pozheran
- 2.QMF-Sllatinë e Epërme
- 3.QMF-Smirë
- 4.QMF- Sodovinë
- 5.AMF-Beguncë
- 6.AMF-Skifteraj
- 8.AMF-Stubëll
- 9.AMF-Tërpezë
- 10.Leticë

#### Gjendja në terren

1. Në Qendrën Mjekësore familjare në Pozheran punohet 24 orë pa ndërprerë. Në kuader të kësaj qendre ofrohen të gjitha shërbimet e mjekësisë familjare, si dhe shërbime stomatologjie, por edhe kryhen analiza të ndryshme laboratorike gjatë ndërrimit të parë.
2. Qendra e Mjekësisë Familjare në Sllatinë të Epërme ofron shërbime infermierie dhe Mjeku gjatë gjithë javës në orar të rregullt.
3. Në QMF-në në fshatin Smirë punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, me shërbime infermierie, kurse Mjeku dy herë në javë.
5. Në QMF-në në fshatin Sadovin e Jerlive punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, me shërbime infermierie, kurse Mjeku tri herë në javë.
6. Në AMF-në e Skifterajt punohet dhe ofrohen shërbime çdo ditë punë nga ana e infermierëve përveç vikendit, ndërsa shërbimet e Mjekut mund ti marrin në tri ditë pune.
7. Në AMF-në e fshatit Beguncë ofrohen shërbime infermiere çdo ditë pune përveç vikendit.
8. Në fshatin Tërpezë shërbimet mjekësore ofrohen çdo ditë pune nga infermieret ndërsa nga ana e Mjekut shërbimet jepen dy herë në javë.
9. Në AMF-në në fshatin Stubëll e Epërme punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, me shërbime infermierie, kurse Mjeku një herë në javë.
10. Në AMF-në në Letnicë shërbimet shëndetësore nga Mjeku jepen një herë në javë.

#### Shërbimet e ofruara nga QKMF-ja –QMF-ja dhe AMF-të

Shërbimet të cilat u janë ofruar qytetarëve në QKMF, QMF dhe AMF-të për këtë pesëmuor janë dhënë gjithsejtë **166,918.00** shërbime. Për më tepër, të gjitha llojet e shërbimeve janë të paraqitura përmes tabelës që i bashkëngjitet këtij raporti. (Shih tabelën) Mjetet e grumbulluara nga participimi për shërbime shëndetësore janë **16,429.50 €**. Gjithashtu për çdo muaj veç e veç mund të shihet në tabelën e bashkangjitur. (Shih tabelën).

Pasqyra e mjeteve të grumbulluara nga participimi

N r.	Shërbimi	Jana r	Shku rt	Mars	Prill	Maj	Qesh or	Korri k	Gusht	Shtat or	Teto r	Nënt or	Dhje tor	githëse j
1	Emergjenc a	907.5	1548	837.5	161		712.5							4166.5
282	Arka 1	2277.6	2390	1212.8	308.8		1059.2							7248.5
3	Pozheran	1401	1405.5	982	221.5		1004.5							5014.5
4	Gjylekar													
5	Tërpez													
6	Smirë													
7	Sllatinë													
8	Remnik													
9	Beguncë													
10	Sadovin e Jerlive													
11	Goshicë													
12	Letnicë													
13	Stubell e E.													
14	Gjithsej	4586.1	5343.6	3032.3	691.3		2776.2							16429.5

<b>RAPORTE</b>	<b>Vizita</b>	<b>Therrje</b>	<b>Infuione</b>	<b>Transfer</b>	<b>Transfere diagno.</b>	<b>Lidhje</b>	<b>Inhalime</b>	<b>Këshilla</b>	<b>Ekg</b>	<b>Nr. Analizave</b>	<b>Ndërrim</b>	<b>Nr.nxerrje ve.</b>	<b>Liruar nga pagesa</b>
Emergjenca	18446	11458	4714	1817		732			376				15559
Mjekësia familjare 1	7735	3720		1260									9000
Mjekësiafamiljare 2 dhe 3	5933			1174									4741
Stomatologjia	1148											351	1099
Rtg	785												528

Ekipi i terrenit	289	315	275			56					192		839
Dhoma e infuzioneve			1361										1056
Laboratori	3684									4275 7			2939
Pediatria	1424			24	43			71					1424
Interno	371								178				307
Kontrolla gjinekologjike		90						71					157
Shërbimi i vaksinimit	1650	4166											1650
Inhalime në QKMF							17 1						171
Lidhorja						835							810
Ambulanta Smirë	132	98	29	1		22		89					370
Amb.Sadovin e Jerl,	160	173				79		52					306
Amb.Sllatinë	183	254	65	5		66	5	25					539
Amb.Pozheran	16879	8249	3130	2408		711	5	6	134				13490
Lab.Pozheran	1648									1916 7			1384
Stom.Pozheran	292											127	278
Amb. Terpeze	90	87	15			89	19	66					372
Amb.Skifteraj	119	151	13	7		26		48					359
Amb.Beguncë	19	98				64	6	39					278
Amb. Letnicë	15	1											16
Amb.Stubëll	488	96				64	14	38					530
													<b>58268</b>
	<b>61601</b>	<b>2895</b>	<b>9602</b>	<b>6696</b>	<b>43</b>	<b>274</b>	<b>22</b>	<b>505</b>	<b>688</b>	<b>6192</b>	<b>196</b>	<b>478</b>	
		<b>6</b>				<b>8</b>	<b>0</b>			<b>4</b>			

**166918**

**GJITHSEJTË  
SHËRBIME**

Llojet e shërbimeve shëndetësore në QKMF, QMF dhe Amf-të

**Zhvillimi drejt ngritjes së cilësisë së kujdesit shëndetësor**

- a) Menaxhmenti i QKMF-së, Viti është munduar të rris kualitetin e shërbimeve shëndetësore përmes trajnimeve të stafit mjekësor dhe infermierik, përmes seminareve dhe trajnimeve të ndryshme. Gjatë kësaj periudhe punëtorët shëndetësor kanë qenë pjesë e trajnimeve të organizuara në Viti , Gjilan dhe Prishtinë.

### III-Raport nga Qendra për Punë Sociale Janar –Dhjetor 2019

Qendra për Punë Sociale (QPS) është organ publik i administratës e cila aktivitetin e vet punues e ushtron në kuadër të administratës Komunale në Viti, njësi e DSHMS, ofron shërbime për të gjithë qytetaret që gjenden në territorit e Komunës e që kanë nevojë për këto shërbime. Përperiudhën kohore 01.01 deri më 31. 12. 2019, punët në kuadër të QPS-Viti janë të paraqitura në tabela.

#### RAPORTI I SHËRBIMIT SOCIAL/QPS-së NË VITI, PËR GJASHTË MUJORIN E PARË-2020

Kategoritë e rasteve	Raste te reja	Përsëritës	Te bartura nga vitet tjera	Gjithsejtë	Vendosja ne institucione
Raporte te çrregulluara bashkë-besim i fëmijëve	2	0	5	7	
Te mitur ne konflikt me Ligjin	11	10	73	94	
Dhuna ne familje	19	0	25	39	
Te mitur me sjellje asociale	2	0	7	9	
Fëmijët e keqtrajtuar fizikisht	4	0	14	18	
Kujdestari e fëmijëve	2	0	27	29	
Fëmijët ne streh. familjar te te afërmit	0	0	9	9	
Fëmijët e vendosur ne famil. strehuese	2	0	0	2	
Adoptimi i fëmijëve	3	0	5	8	
Kontaktimet prind-fëmijë.	2	0	10	12	
Keqtrajtimet-ngacmimet sex.te fëmijëve.	2	0	0	2	
Te moshuar pa përkujdesje familjare	1	0	3	4	3-SHPMPF
Te rritur me nevoja te veçanta.	0	0	4		Ne Shtime,3 ne Ferizaj 1 dhe ne Kamenice 1

Fëmijët me nevoja te veçanta.	2	0	49	51	
Ftesa gjyqësore për te mitur	12	0	0	12	
Ftesa gjyqësore për te rritur	11	0	0	11	
Lypës te rrugës	0	0	0	0	
Masat e shqiptuara për te mitur; M.SH.P	5	0	0	5	
M.O.K.	3	0	0	3	
Qortim	2	0	0	2	
Burg	0	0	0	0	
Vërtetime për nënshtetësi	30	0	0	30	
Vërtetime për zotësi veprimi-Armë	34	0	0	34	
Vërtetime për zotësi veprimi-Punë	7	0	0	7	
Punë të renda te fëmijëve	2	0	0	2	
Ankesa komis. mjekësor shk.II	0	0	0	0	
Fëmijët e vendosur ne institucionet mbrojtëse	0	0	1	1	
Vendosja strehim-dhunë familje	0	0	0	0	
Regjistr.i mëvonshëm i fëmijëve	0	0	0	0	
Përdorues te narkotikeve	0	0	0	0	
Martesa të parakohshme	0	0	0	0	

Urdhër mbrojtje për viktimat e dhunës në familje	3	0	0	3	
Shërim i detyrueshëm psikiatrik	1	0	0	1	
Kërcënime	1	0	0	1	
Raste tjera në nevojë për shërbime	21	0	0	21	

## SHËRBIMI I ASISTENCES SOCIALE

<b>PASQYRA E PAGESAVE TË ASISTENCËS SOCIALE PËR PERIUDHËN Janar-Qershor-2020</b>			
<i>Nr.</i>	<i>Muaji</i>	<i>Pagesa mujore</i>	<i>Gjithsej familje</i>
<i>1.</i>	<i>Janar</i>	<i>48792.50 €</i>	<i>452</i>
<i>2.</i>	<i>Shkurt</i>	<i>49790.00 €</i>	<i>458</i>
<i>3.</i>	<i>Mars</i>	<i>48642.00 €</i>	<i>441</i>
<i>4.</i>	<i>Prill</i>	<i>100395.00 €</i>	<i>461</i>
<i>5.</i>	<i>Maj</i>	<i>100097.50 €</i>	<i>465</i>
<i>6.</i>			
	<i>Totali</i>	<i>347717,00€</i>	<i>Mesatarja 455</i>

## DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË

Gjatë kësaj periudhe, ne si Komunë jemi ballafaquar edhe me pandeminë COVID-19, edhe pse me kushte të vështirësuar, mirëpo drejtoria jonë ka punuar me kapacitete të plota në ofrimin e shërbimeve komunale.

### Sektori i shërbimeve publike

Gjatë periudhës janar – qershor 2020, ky sektor ka pranuar gjithsej 105 kërkesa të natyrave të ndryshme, të cilat i kemi kryer në afatin ligjor. Kemi lëshuar vendime të ndryshme, leje për parkim, vazhdimi i lejeve për auto-taxi dhe ngarkesa për shfrytëzimin e hapësirave publike për vitin 2020, si dhe janë bërë pagesa për shfrytëzimin e hapësirave publike, vendosjen e reklamave etj.

Gjatë kësaj periudhe kemi përcjell punët e operatorëve të kontraktuar nga Komuna, të cilit kanë kryer shërbime për Komunën.

### Mirëmbajtja verore – dimërore e rrugëve lokale

Kemi përcjell punët e kompanisë për mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve si: Pastrimi i rrugëve lokale nga akulli dhe bora, mbushjen e gropave me asfalt nëpër rrugë të asfaltuara, furnizimin me zhavor nëpër rrugët e rendit të katërt, pastrimi i bankinave të rrugëve lokale nga barojat dhe shkurret etj.



## **Mirëmbajtja e HHP**

Mirëmbajtjen e HHP gjatë periudhës raportuese e ka bërë operatori ekonomik Shpk "Arbor Group" nga Kamenica.

-Janë përcjelle punët për mirëmbajtje dhe pastrim të qytetit dhe HHP, në bazë të kontratës dhe paramas.

Me Hapësira të Hapura Publike (HHP) të përfshira në këtë projekt nënkuptohen të gjitha sipërfaqet publike me rendësi për zhvillimin e jetës shoqërore dhe publike në qytetin e Komunën e Vitisë.

Janë mirëmbajta: parqet, sheshet, shëtitorja Viti-Bince, shtrati i lumit "Morava", sipërfaqe gjelbëruese, Hapësirat për parkim automjetesh, rrugët, trotualet, tregjet, lapidarë, pllakat përkujtimore, Varrezat e Dëshmorëve dhe varrezat e qytetit të Vitisë. Është bere edhe krasitja e drunjeve dekorativ në qytet, mbjellja e drunjeve dekorativ, mbjellja e luleve ne qytet etj.

## **Pastrimi i objekteve komunale, shëndetësore dhe arsimore**

Me pastrimin e objekteve komunale, shëndetësore dhe arsimore, është marrë kompania, Aroma Plus shpk & Krasniqi Shpk& Ntp Beni nga Prishtina. Të gjitha objektet komunale shëndetësore dhe arsimore janë mirëmbajta sipas kontratës dhe paramasës .Kompania ne fjale ka punuar me tere kapacitetet edhe gjate pandemisë nga virusi COVID-19.

## **Ndriçimi publik**

Në komunën tone kemi gjithsej llampa elektrike 10.882 cope, te cilat janë te vendosura ne shtylla elektrike druri, betoni dhe shtylla metalike te zinguara. Kemi tri lloj te llampave elektrike: llampa me natrium-(zhive)-100 cope, poça ekonomik 65 Ë -4233 cope dhe te llojit LED 100W,50V,11 Ë,16W, gjithsej 6549 cope.

Gjate kësaj periudhe raportuese është intervenuar vazhdimisht ne evitimin e defekteve dhe ne nderimin e poqave elektrike: Llusterat-100cope,fotoqeli-15 cope, poqa 65Ë-189copa,poqa 11Ë-118 cope, role kohore 45 cope, kontaktor -20 cope, LED 50Ë-368 cope, LED 16Ë -42 cope, reflektor 14 cope, kabell elektrike -277 metra gjatësi, shtylla elektrike te zingur 9 metershe-3 cope, dislokim i rrjetit te ndriçimit elektrik nga shtyllat e drurit me ato te betonit ne total-586 metra gjatësi.

Ndriçimi publik gjatë kësaj periudhe raportuese në Viti dhe lokalitetet e Komunës sonë, është duke u mirëmbajtur nga operatori "Termomontimi" shpk. - Prishtine, në bazë të kontratës dhe paramasës. Vazhdimisht kemi intervenuar ne sanimin dhe eliminimin e defekteve ne rrjetin e ndriçimit publik.

## **Mirëmbajtja e aparateve kundër zjarrit**

Me këtë projekt njëvjeçar, mirëmbahen aparatet kundër zjarrit për NJPZ, institucionet komunale, arsimore dhe shëndetësore Servisimi bëhet çdo 6 muaj:

Janë servisuar:

Aparat kundër zjarrit P-6kg.....66 cope

-Aparat kundër zjarrit P-9kg.....144 cope

-Aparat kundër zjarrit P-50kg.....4 cope

-Aparat kundër zjarrit CO2-5kg.....13 cope

Ndërsa janë rimbush 41 aparate kundër zjarrit dhe ate:

-Aparate kundër zjarrit P-9kg.....23 cope

-Aparate kundër zjarrit P-6kg.....16 cope

-Aparate kundër zjarrit CO2-5kg.....2 cope

## **Furnizimi me veshmbathje verore për NJPZSH**

Zjarrfikësit janë furnizuar me këpucë verore, pantallona për sezonin veror dhe maica.

## Ujësjetllësi dhe kanalizimi

Në komunën tonë për mirëmbajtjen e sistemit të ujësjetllësit dhe kanalizimit, përgjegjëse është kompania regjionale “**Hidromorava**”, njësi në Viti. Kompania ne fjalë, bënë furnizimin me ujë të pijshëm dhe mirëmban kanalizimin, ne qytetin e Vitis, fsh. Drobesh, Ramnishte, Pozharan, Qifllak dhe Letnicë.

Ndërsa, ne lokalitet tjera ku rrjetet e ujësjetllësve dhe rrjetet e kanalizimeve nuk mirëmbahen nga kompania regjionale “**Hidromorava**”, njësi në Viti, janë mirëmbajtur nga operatori ekonomik „Vizioni BD,” i kontraktuar nga Komuna e jone. Janë përcjell punët e kompanisë për mirëmbajtjen e ujësjetllësve dhe kanalizimeve nga ana e drejtorisë dhe gjate kësaj periudhe raportuese janë bere 17 intervenime ne rregullimin e kanalizimeve dhe ujësjetllësve, zhbllokim te kanalizimeve e tj.

Me poshtë po paraqesim llojin e intervenimit dhe lokalitetet ku janë evituar defektet :

Në fshatin Gërmovë është intervenu në pastrimin e katër pusetave të kanalizimit fekal si dhe ndërrimin e gypit  $\phi 110$ - $\phi 200$ , në gjatësi prej 19 metra si dhe vendosja e një kapaku të betonit.

-Në fshatin Podgorcë është intervenu në pastrimin e katër pusetave të kanalizimit fekal si dhe ndërrimin e gypit  $\phi 250$ - $\phi 400$ , në gjatësi prej 32 metra si dhe vendosja e një kapaku të betonit.

-Në fshatin Trestenikë është intervenu në pastrimin e tri pusetave të kanalizimit fekal.

-Në fshatin Kabash është intervenu në pastrimin e katër pusetave të kanalizimit fekal si dhe ndërrimin e gypit  $\phi 250$ - $\phi 400$ , në gjatësi prej 24 metra.

-Në fshatin Podgorcë është intervenu në pastrimin e pesë pusetave të kanalizimit fekal si dhe ndërrimin e gypit  $\phi 250$ - $\phi 400$ , në gjatësi prej 32 metra si dhe vendosja e një kapaku të betonit.

-Në fshatin Gjylekar është intervenu në pastrimin e katër pusetave të kanalizimit fekal si dhe si vendosja e dy kapakëve të metalt.

-Në fshatin Kabash është intervenu në pastrimin e dy pusetave të kanalizimit fekal si dhe ndërrimin e gypit  $\phi 250$ - $\phi 400$ , në gjatësi prej 6 metra si dhe vendosja e një kapaku të metalt.

-Në qytetin e Vitisë është intervenu në pastrimin e tri pusetave të kanalizimit fekal si dhe vendosja e një kapaku të metalt.

-Në fshatin Gjylekar është intervenu në ndërrimin e gypit  $\phi 110$ - $\phi 200$ , në gjatësi prej 6 metra.

-Në fshatin Gjylekar është intervenu në pastrimin e dy pusetave të kanalizimit fekal si dhe ndërrimin e gypit  $\phi 250$ - $\phi 400$ , në gjatësi prej 20 metra, vendosja e tre gypave të betonit për puseta  $\phi 800$  si dhe vendosja e një kapaku të metalt.

-Në qytetin e Vitisë është intervenu në pastrimin e dy pusetave të kanalizimit fekal si dhe vendosja e tre kapakëve të betonit.

-Në fshatin Sllatinë e Epërme është intervenu në pastrimin e një pusete të kanalizimit fekal si dhe vendosja e një kapaku të betonit.

-Në fshatin Sodovinë e Jerlive është intervenu në pastrimin e dy pusetave të kanalizimit fekal.

-Në fshatin Smirë është intervenu në pastrimin e dy pusetave të kanalizimit fekal.

-Në fshatin Sllatinë e Poshtme është intervenu në pastrimin e katër pusetave të kanalizimit fekal si dhe si dhe vendosjen e pesë kapaku të betonit.

-Në qytetin e Vitisë është intervenu në pastrimin e një pusetave të kanalizimit fekal si dhe vendosja e një kapaku të betonit.

-Në Podgorcë është intervenu në pastrimin e dy pusetave të kanalizimit fekal si dhe ndërrimin e gypit  $\phi 250$ , në gjatësi prej 6 metra.

-Në fshatin Letnicë është intervenu në vendosjen e një kapaku të metalt.

## Mbeturinat

Eco-Higjiena si kompani publiko-private, njësia në Viti, bënë mbledhjen, transportimin e mbeturinave në deponin regjionale ne Velekinc te Gjilanit dhe atë nga këto vendbanime të Komunës: Qyteti i Vitisë, Drobesh, Smirë, Terpezë, Pozheran, Sllatinë e Eperme, Slatine e Ulët, Radivojcë, Fshati Ri, Budrik, Remnik, Ramjan, Beguncë, Kabash, Germovë ,Sodovin e Jerlive ,Sadovin e Qerkezeve, Verban, Ramnisht ,Goshicë , Skifteraj, Terstenik, Podgorc, Stubëll e Epërme, Lubishte, Binqe, Devaje dhe Qifllak. Kompania ne fjale gjate kësaj periudhe raportuese ka grumbulluar dhe ka transportuar 2370 ton mbetje komunale ne deponin e Velekinces.

Duhet përmendur faktin se donacioni i fituar nga Komuna e jone, nga Grandi i performances, nga GIZ-Gjerman dhe Ministria e Planifikimit hapësinor dhe Mbrojtje te Mjedisit, po ju kthehet qytetarëve, duke i furnizuar me kontejner familjar 120 L dhe kontejner plastike e te metalta me mase vëllimi prej 1.1 m<sup>3</sup>. Këta kontejner ,e qe janë gjithsej 2655 kontejner familjar dhe 126 kontejner 1.1 m<sup>3</sup>, kanë filluar te shpërndahen nga ana e kompanisë klientëve te rinje dhe te vjetër dhe kontejnerët 1.1 m<sup>3</sup> janë vendosur ne disa pika ne qytet dhe po zëvendohen te dëmtuarit neper institucione.

## Deponitë ilegale

Gjatë kësaj periudhe 6-mujore jane evidentuar 21 deponi ilegale. Këtë pune e kanë kryer dy drejtoritë, DSHPE-ja dhe DI-Inspektori i ambientit, ne koordinim me përfaqësuesin e GIZ-Gjerman.

Me poshtë do te pasqyrojmë vende-lokacionet dhe numrin e deponive ilegale.

Nr.	Vendi I deponive	Sasia	Komuna
1	Binqë	1	Viti
2	Devaj	1	Viti
3	Drobesh	2	Viti
4	Begunce	2	Viti
5	Radivojc	1	Viti
6	Skifteraj	2	Viti
7	Remnik	1	Viti
8	Stublla e Epërme	2	Viti
9	Lubishte	1	Viti
10	Kabash	2	Viti

11	Sadovin e Jerlive	1	Viti
12	Sllatin e Ulte	2	Viti
13	Pozheran	2	Viti
14	Zhiti	1	Viti
	<b>Totali</b>	<b>21</b>	<b>Deponi</b>

### **Punët me Skipin e Komunës**

Hapja e kanaleve të ndryshme ,largimin e borës nga rruga ne disa rrugica te qytetit dhe ne disa lokalitete rurale, largimin e mbeturinave inerte ,varrosjen e kafshëve te ngordhura, mbyllja e rrugëve malore me kërkesë të Drejtorisë se Bujqësisë, rregullimi i hapësirave publike dhe rregullimi i rrugëve nga gërryerjet erosive. Pra, me skipin e komunës janë kryer pune te ndryshme dhe ate në total 150 orë pune për këtë periudhe raportuese.

### **Sektori i emergjencave**

Azhurimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknike në rast fatkeqësish. (janar-mars).

1. Bashkëpunimi me SHZSH.
2. Punët e përditshme administrative.
3. Takimet me QRAK-pandemia nga 12 mars deri tash.
4. Angazhimi rreth zjarreve pyjore ne shkurt-mars 2020.
5. Përgatitja e materialeve për vërshime për nivelin qendror. (demet mëhershme, gjendja e lumenjve dhe prockave, vlerësimi i rrezikut, etj.
6. Implementimi i Vendimeve të Kryetarit të Komunës në Komisione Komunale.
7. Angazhimi në pastrimin e gurëve në rrugën e Letnicës nga shemja.
8. Azhurimi i të dhënave dhe dërgimi në AME, Qendra Operative Lokale

### **Njësia profesionale e zjarrfikjes dhe shpëtimit**

NJPZSH ne Viti, gjate kësaj periudhe raportuese i ka kryer me përgjegjësi profesionale te gjitha punët dhe detyrat te cilat me ligje është e obliguar t i kryej. Edhe gjate kësaj periudhe te Pandemisë, njësiti ka punuar me kapacitete te plota, fatmirësisht nuk ka pasur asnjë te prekur me COVID-19.

Numri i përgjithshëm i daljeve 216; zjarre 131; shërbime 66; intervenime teknike 13; aksidente rrugore 4 dhe thirrje të rrejshme 2.

Gjatë periudhës së pandemisë Njësiti i zjarrfikëseve vazhdimisht ka bërë klorifikimin e rrugëve në qytet dhe në vatrat e prekura nga COVID –19.

### **Inspektori i preventives ndaj zjarrit**

Inspektime në vende ngjarje	.....	15
· Nr. i propozimit të masave	.....	55
· Vendeshiqimet e zjareve	.....	14
· Vërtetime për prokurori	....	7

## **Aktivitet gjatë covid-19, Dezinfektimi i objekteve Shkollore, Komunale dhe Hapësirave Publike**

Gjatë kësaj periudhe raportuese ,nga 13.03.2020,jemi ballafaquar me pandeminë COVID-19 dhe me operatorin ekonomik të kontraktuar nga komuna “Ekologjia”SHPK-Ferizaj, është bërë dezinfektimi i objekteve komunale, shëndetësorë, arsimore, fetare, objekteve private (ku kanë jetuar te prekurit nga kjo epidemi dhe hapësirat publike. Janë dezinfektuar edhe objektet e organeve shtetërore, Gjykata dhe Policia. Vlen te theksohet se me dezinfektim është marre edhe një kompani private Everi Day VM,SHPK nga Ferizaji , e cila ka bere dezinfektimin sipas kërkesave te komunës e qe ka qenë donacion.

### **Furnizimi me pako ushqimore**

Është realizuar projekti për furnizim me pako ushqimore për familjet me nevojë, gjatë periudhës së pandemisë, ku DSHPE-së ka asistuar në shpërndarjen e tyre.

### **Aktivitet tjera**

Gjatë kësaj periudhe raportuese DSHPE-së në bashkëpunim me GIZIN-Gjerman , ka përgatitur Draft Planin për menaxhimin e mbeturinave dhe me grupin punuese ka punuar ne Draft Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave. Angazhimi i një pjese te stafit te drejtorisë ne Komitetin Komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim, si dhe ne Qendrën Operative Emergjente, ne luftimin e Pandemisë COVID-19 nga dt.13.03.2020.

## **DREJTORIA PËR INSPEKSION**

Në këtë periudhë të gjashtëmuorit të parë, Drejtoria e inspeksionit ka qenë e angazhuar në zbatimin e vendimeve të IKSHP dhe Ministrisë së Shëndetësisë për zbatimin e masave parandaluese të sëmundjes infektive COVID-19. Andaj edhe puna e inspektorëve kanë qenë të angazhuar 24 orë dhe iu kemi përgjigjur të gjitha rasteve të kontrolleve në bashkëpunim edhe me stacionin Policor në Viti, dhe në rastet e shkeljeve të këtyre masave kemi aplikuar edhe masa ndëshkimore administrative.

### **Inspektorët e tregtisë**

- 32 Procesverbale mbi legalizimin e veprimtarisë së subjekteve të biznesit dhe pajisje me leje pune dhe mbikëqyrjet tjera ne aspektin e zbatimit te ligjit 2004/për legalizim te veprimtarisë si dhe pajisje me pranim teknik te lokaleve, si dhe bizneset qe kane nderru selinë e veprimtarisë apo kane zgjeruar hapësirat afariste janë detyruar qe te harmonizojnë veprimet e tyre ne pajtim me ligjet ne fuqi.
- 14 Kontrolle te përbashkëta me Policin e Kosovës për respektimin e vendimeve të institucioneve qendrore, në parandalimin e sëmundjes Covid-19 në qendrat tregtare dhe bizneset tjera që operojnë në Komunën e Vitisë.
- 10 Kontrolle mbi kualitetin, cilësinë, sigurinë e produkteve ne qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve, së bashku me Inspektorët sanitarë, të veterinarisë, ku janë asgjësuar sasi e konsiderueshme e mallit të rrezikshëm për jetën dhe shëndetin e konsumatorëve.
- Nga kontrollet e ushtruara më lart, janë urdhëruar bizneset që të shpallim edhe njoftimet për ndalim shitjen, shërbim dhe dhurimit e duhanit dhe pijeve alkoolike personave nën moshën 18.

### **Inspektori i veterinarisë**

Marrja e mostrave të gjakut për sëmundje infektive: mbi 55 mostra te marrura, prej tyre pesë (bletëve), kanë rezultuar pozitiv në Pestë Amerikane në fshatrat Gërmovë, Vërban dhe Drobesh,të cilat edhe janë asgjësuar.

Marrja e mostrave të gjakut tek gjedhet për sëmundje infektive në Brucelozë: mbi 900 mostra te marrura, ndërsa rastet pozitive janë ne dele dhe dhi , 90 prej tyre janë asgjësuar dhe janë të goposura ne varrezat e kafshëve me inspektorët e A.U.V-së dhe është duke u vazhduar në shëndetësimin e fermave.

- Inspektimi i vazhdueshëm i thertores në Pozhoran
- Inspektime të marketeve dhe bizneseve tjera, të ushqimeve me prejardhje shtazore
- Marrje te mostrave në mishtore: Pozhoran dhe Viti .
- Gjitha ngordhjet e kafshëve në teren që fermerët i kanë hudh, që ne nuk kemi pas mundësi identifikim janë gropos 25 krerë
- Inspektim tregut të kafshëve dhe tregut të gjelbër.
- Takime me qytetarë në zyrë për probleme të ndryshme që i shqetësojnë qytetaret, dhe punë të tjera që i kontribuojnë drejtorisë.

### **Inspektori i mbrojtjes mjedisit**

-Kemi inspektuar rrjetet e kanalizimit kolektiv të ujërave të zeza, ku një pjesë e tyre nuk përfundojnë në gropa septike dhe nuk kanë mbikëqyrje nga kompanitë kompetente.

-Në disa fshatra kemi shpërndarë njoftime publike lidhur me ruajtjen e mjedisit dhe pasojat ligjore për ndotësit e mjedisit.

- Kemi marrë pjesë në aksionin e pastrimit të mjedisit me 22 Prill „ Dita e Tokës” dhe 5 Qershorin „ Dita e Mjedisit” si dhe aksionin tremujor për pastrimin e mjedisit nga mbeturinat me moton „ Ta Pastrojmë Kosovën”.

-Kemi marrë iniciativë për funksionalizimin e deponive të mbeturinave të ngurta ( ndërtimore) dhe janë caktuar tri pika : Binçë, Radivojc dhe pika mes të fshatit Sllatinë e Epërme –Trestenik.

Kemi marrë pjesë në Gjykatë për shqyrtimin e lëndëve.

Shqiptimi i 4 gjobave mandatore

Në këtë periudhë kemi ndërprerë 15 aktivitete ndotëse

Largimi i plehërave të kafshëve 8 raste

Ndalimi i rrjedhjes të ujërave të zeza në ambient të hapur 3,në Skifteraj, Viti dhe Fshat i ri.

Konstatim:gjendja mjedisore në territorin e komunës nuk është e kënaqshme sidomos (mbeturinave dhe ujërave të zeza), në lokalitetet ku mungon menaxhimi i mbeturinave përmes kompanisë dhe rrjeta e kanalizimit kolektiv.

Mungojnë gropat septike të kanalizimit kolektiv.

Edhe pse disa fshatra kanë shpreh interesim për menaxhimin e mbeturinave komunale përmes kompanisë, nuk ju kanë ofruar shërbim (Letnica, Podgorci etj).

### **Inspektori i komunikacionit**

Kemi menaxhuar furnizimin dhe vendosjen e shenjave të Komunikacionit sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës në tërë territorin e komunës së Vitisë.

Kemi hartuar 11 procesverbale sipas detyrës zyrtare.

Kemi lëshuar gjithsejtë 8 (tetë) LEJE për vendosjen e pengesave 2 në Podgorc, 1 në Binçë , 1 në Rr.” Mustafë Koka “ në Viti, Tërpezë, Kabash etj.

Kemi hartuar 48 Procesverbale mbi shikimin e Automjetit për transport publik -Taxi

Kemi bërë 50 Fletëpagesa për taksa komunale dhe atë 48 mbi shikimin e automjetit në vlerë prej 10 €, dhe 2 për Pëlqim mbi kyçjen në rrugë.

Kemi bërë pranimin teknik të lokaleve së bashku me Ins. E Tregtisë dhe atë Sanitarë.

Pastaj kemi qenë edhe nëpër komisione të ndryshme si hapje të ofertave , vlerësime si dhe të pranimit të punimeve me vendime nga kryetari, si kanalizime, rrjete të ujësjellësit rrugë trotuare etj.

### **Inspektorët e ndërtimit**

Në bazë të planit dhe programit të punës për këtë periudhë kemi zhvilluar këto aktivitete:

- Me këtë rast kemi hartuar **37** procesverbale lidhur me fillin e punimeve të pa pajisura me dokumente për ndërtim.
- Gjithashtu kemi hartuar **25** Vendime për ndërprerjen e punimeve
- Kemi përgatitur dhe proceduar për Gjykatë këto lëndë:
- Për Kundërvajtje = **12**
- Për Vepër penale = **9**
- Lëndë në procedurë = **5**
- Lëndë të përfaqësuara në Gjykatën Komunale = **11**
- Kemi realizuar gjithsejtë **85** vizita në teren.

### Inspektori i sanitarisë

Nr	INSPEKTIME	Shprehur ne numra
1	Inspektime te objekteve afariste	<b>81</b>
2	Pranime teknike te lokaleve	<b>21</b>
4	Procesverbale	<b>54</b>
5	D-D-D	<b>58</b>
6	Inspektime te ujërave te pijshëm	<b>22</b>
7	Inspektime te ujërave te zeza	<b>0</b>
8	Mostra te ujerave rurale	<b>0</b>
9	Mostra te ushqimeve	<b>0</b>
10	Pëlqime Sanitare	<b>6</b>
11	Aktvendime	<b>10</b>
12	Kundërvajtje	<b>0</b>
13	Shqiptimi i gjobave administrative	<b>8</b>
14	Libreza Sanitare	<b>55 %</b>
15	Inspektime te tregut	<b>6</b>
16	Asegjasim te artikujve ushqimor	<b>26 tonë</b>
18	Urdhëresa	<b>2</b>
19	Inspektime te objekteve shkollore	<b>4</b>
20	Inspektime te objekteve shëndetësore	<b>6</b>
21	Inspektime te pishinave	<b>2</b>
22	Exhumime	<b>0</b>
23	Vendime për Karantinim në rastet pozitive	<b>30</b>

## DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

### I. Shënimi i aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive Janar-Qershor /2020

Ne kuadër të DKRS/së si sektor funksionin edhe **Spektori i Bibliotekës Publike Komunale** me dy bibliotekat amë (për fëmijë dhe të rritur) dhe dy bibliotekat në degë (Pozheran dhe Sllatinë), gjatë gjashtëmuorit të parë,

sektori i bibliotekës përveç shërbimit cilësor dhe aktiviteteve bibliotekare është fokusuar edhe në pasurimin e fondit. Ajo ka pasuruar fondit e vet me: 17 tituj, 24 ekzemplarë.

Me qëllim të parandalimit të Pandemisë COVID/ 19, Qeveria e Kosovës merr vendim që të reduktoj dhe të ndërpres një sere shërbimesh. Në këtë rast edhe shërbimi ynë/ Biblioteka, ka ndërpre shërbimin që nga data 16.03.2020. Andaj si rezultat nuk kemi mundur që t'i arrijmë qëllimet dhe objektivat po për këtë periudhë. Po ashtu, si sektor në kuadër të DKRS-së funksionin edhe Arkivi Historik.

**Sektori i Arkivit Historik** ka filluar zbatimin e ligjit të ri për Arkivat Shtetërore nr.04/L-088, konkretisht nenin 7, e që ka të bëjë me dhënien e certifikatave dhe dëftesave për shkolla të mesme. Krahas këtij ligji gjithashtu si pjesë e pandarë fillon se aplikuari edhe neni 38 i Procedurës Administrative e cila rregullon në detaje të drejtat dhe obligimet e palëve që janë pjesëmarrëse në këtë procedure. Përveç punëve rutinë, shërbimit cilësor dhe përgjigjes në kërkesa nga palët Brenda afateve ligjore, është hartuar evidenca e të gjitha regjistraturave atkive dhe pasive që janë regjistruar në territorin ne Komunës së Vitisë. Arkivi historik gjatë gjashtëmujorit të parë ka pranuar 41 Kërkesa, Të realizuara janë: 28, ndërsa të porealizuara 13, ndërsa 1 ne proces.

**Kalendari i aktiviteteve (te mbështetura dhe te realizuara) Janar - Qershor 2020:**

**Sektori i Kulturës, Rinise dhe Sportit:**

<i>MUAJI</i>	<i>NGJARJA</i>	<i>AGJENDA E AKTIVITETEVE TE REALIZUARA</i>	<i>Vendi</i>
<b>JANAR</b>	<p><i>Analizë e punës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2020.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Raporti i punës për vitin 2019</li> <li>• Bashkëpunimi vjetor me KFOK/LMT për vitin 2019</li> <li>• Bashkëpunimi me OJQ</li> <li>• Thirrja publike për subvencionim OJQ – ve</li> <li>• Incizimi kontinuel i arkivimi në TV</li> <li>• Publiciteti medial dhe publikimet ne FCB</li> <li>• Shtypja e Vjetarit në shtypshkronjë në 5 ekzemplar për nevojat e drejtorisë</li> <li>• Bashkëpunimi ndër sektorial (institucional)</li> <li>• Raportimi i Performancës së DKRS-së</li> <li>• Hartimi i projektit të manifestimit tradicional kulturor “Flakadani i Karadakut – 2020”</li> <li>• Hartimi i projektit nga fusha e arteve skenike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kemi hartuar raportin e punës për vitin 2019</li> <li>• Përzgjedhja e laureatëve sportiv është bere sipas kriterëve nga Medaljet Olimpikë, kampionatet Botërore, Evropiane, Ballkanike Kombëtare e lokale.</li> <li>• Incizimi dhe transmetimi ne “Plus TV” për aktiviteteve vjetore</li> <li>• Publikimi i Fotografive nga aktivitetet e zhvilluara mujore ne FCB</li> <li>• Përgatitja teknike dhe Shtypja e Vjetarit në shtypshkronjë në 5 ekzemplar për nevojat e drejtorisë</li> </ul>	



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hartimi i projektit: “ Ditët e diasporës”</li> <li>• Ekspozitë e Artit Pamor</li> <li>• Më 31 janar 2020 shpallja e Laureatëve të vitit 2018</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Takime konsultative me OJQ-te</li> <li>• Bashkëpunimi me KFORIN Ndeshje basketbolli Futboll Hiking</li> <li>• Raportimi i performancës është shty nga Ministria ne kohe te pa caktuar</li> <li>• Kemi hartuar projektin për manifestimin tradicional “Flakdani i Kardakut 2020”</li> <li>• Kemi hartuar ne bashkëpunim me SHKA “Jonuz Ramdani” , projektin: Ditët e Diasporës” në Viti</li> <li>• Kemi bere hapjen e ekspozitës së artit pamor me artistet vitias me teme: “Frymë Lirie”</li> <li>• Kemi zhvilluar konsulte me grupet artistike të Komunës së Vitisë</li> </ul> <p>Kemi organizuar mbrëmjen solemne me rastin e zgjedhjes se artistit të vitit 2019.</p>	
<p><b>SHKURT</b></p>	<p><i>“17 Shkurti, Dita e Pavarësisë së Kosovës”</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Koncerti artistik për Ditën e Pavarësisë</li> <li>• Organizimi i Orës Letrare –Klubi letrar i Shkollës së Mesme “Kuvendi i Lezhës”</li> <li>• Shfaqje kontinuele vjetore e filmave të zhanreve të ndryshëm</li> <li>• Monitorimin e implementimit të projekteve infrastrukturore</li> <li>• Organizimi i aktiviteteve sportive</li> <li>• Ngritje e kapaciteteve te OJQ-ve për aplikim për Subvencione</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kemi organizuar ne bashkëpunim me SHKA “Kemajl Azizi”, Koncertin festiv për Ditën e pavarësisë</li> <li>• Organizimi i Orës letrare me Klubin letrar të Shkollës së Mesme “Kuvendi i Lezhës”</li> <li>• <b>ATLETIKË</b> – Garat nacionale</li> </ul>	

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Publiciteti medial dhe publikimet ne FCB</li> <li>• Thirrja publike për Subvencione</li> <li>•</li> <li>• Ekspozitë e veprave artizanale</li> <li>• Shënimi i 14 Shkurtit, Ditës së Shën Valentinit</li> <li>• Organizimi i trajnimeve me OJQ dhe grupet artistike për projektet kulturore</li> <li>• Promovim i duhur kulturor</li> <li>• Analizë e Sektorit për subvencione (raportet e OJQ-ve</li> <li>• Fillimi i realizimit të projektit: Restaurimi i Objektivit - Muzeu komunal” mbështetur nga BE-UNDP – CwHB – Kosovo, në marrëveshje me Komunën e Vitisë</li> <li>• Fillimi i realizimit të projektit: Restaurimi i Objektivit - Muzeu komunal” mbështetur nga BE-UNDP – CwHB – Kosovo, në marrëveshje me Komunën e Vitisë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëpunimi vjetor me Qendrën kinematografike te Kosovës</li> <li>• Është shty për periudhën e më vonshme. Pas shfaqjes së pandemisë janë anuluar edhe grandet për OJQ-te</li> <li>• Monitorimin e projektit të Palestrës së sportit, Monitorimin e punimeve të Stadiumit të Vitisë, Monitorimin e punimeve të stadiumit të Pozheranit, Monitorimin e punimeve në stadiumit të Sodovinës J.</li> <li>• Kemi organizuar ne bashkëpunim D. e bujqësisë panairin me punime artizane</li> <li>• Kemi bere promovimin e talenteve te riye nga fusha e kulturës</li> <li>• Organizimi i trajnimeve me grupet artistike dhe SHC</li> <li>• Subvencionet dhe raportet e OJQ-ve</li> <li>• Kemi filluar punën rreth projektit : Restaurimi i Muzeut komunal ne marrëveshje Komuna e Vitisë me CwHB -Kosovo</li> </ul>	

<p><b>MARS</b></p>	<p><i>Projekti: Manifestimi tradicional “Flakdani i Karadakut 2020”.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Hapja solemne e manifestimit – nderzja e Flakadanit – 2020</li> <li>• Garat regjionale të recituesve</li> <li>• Ora e madhe letrare</li> <li>• Festivali Mbarëkombëtar i Ansambleve Kulturore “Flakadani i Karadakut 2020”</li> <li>• Ekspozita e manifestimit</li> <li>• Revista e manifestimit</li> <li>• 7 Marsi Dita e Mësuesit</li> <li>• 8 Marsi Dita e Gruas</li> <li>• Shënimi i 24 marsit, Ditës së bombardime të NATO-së</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kemi filluar përgatitjet për fillimin e manifestimit tradicional kulturor “Flakdani i Kardakut 2020</li> </ul> <p><u>Vërejtje:</u></p> <p>Aktivitete këto te cilat u ndërprejnë për shkak të pandemisë më: 13 Mars 2020.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Për shkak të sëmundjes infektive, pandeminë Coronavirus - Covid 19, me vendimin e qeveris se Kosovës janë anuluar të gjitha aktivitetet me kohë të pacaktuar.</li> </ul>	
<p><b>PRILL</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgatitja e SHKA-ve për manifestimet jashtë Komunës</li> <li>• 3 Prilli, përvjetori i rënies së dëshmorit Sherif Frangu – Akademi Përkujtimore</li> <li>• 8 Prilli, Dita e Kushtetutës së RKS-së</li> <li>• 18 Prilli, Dita Ndërkombëtare e Muzeve</li> <li>• 19 Prilli, përvjetori i rënies së dëshmorit Mejdi Korrani – Film dokumentar</li> <li>• Investimet kapitale në infrastrukturën sportive</li> <li>• 22 Prilli – Dita Botërore e Tokës</li> <li>• Hartimi i agjendës së 5 majit – Dietës e Dëshmoreve</li> <li>• 27 Prilli, Dita e të pagjeturve – Ekspozitë</li> <li>• Promovime kulturore</li> <li>• panairi kulturor</li> <li>• Ekspozita e artit pamor</li> </ul>	<p><u>Vërejtje:</u></p> <p>Aktivitete këto te cilat u ndërprejnë për shkak të pandemisë.</p>	

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Takime pune me grupet artistike të Komunës së Vitisë dhe OJQ-të</li> <li>• Shfaqje filmi etj.</li> </ul>		
<b>MAJ</b>	<p><i>“5 Maji, Dita e Dëshmorëve” në Viti”</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ekspozitë nga fusha e artit pamor</li> <li>• Pjesëmarrja e SHKA-ve. në festivalet e Klinës dhe atij të Përmetit</li> <li>• Turniri tradicional në Futboll të vogël “Nijazi Rexhepi” Sllatinë E.</li> <li>• Përvjetori i dëshmorëve të Pashtrikut</li> <li>• Homazh te varrezat e dëshmorëve</li> <li>• Akademi përkujtimore</li> <li>• Shfaqja e filmit për dëshmorët</li> <li>• 9 Majit Dita e BE-së. – Koncert i zhanrit modern.</li> <li>• Organizimi i tryezës së rrumbullakët me temë “ Liria e shprehjes” 3 Maji Dita përkujtimore e gazetarit Kerim Lewton</li> <li>• Ekspozitë e artit pamor ne bashkëpunim me SHMU- të K. Së Vitisë</li> <li>• Plani i aktiviteteve të 1 qershorit</li> </ul>	<p>Homazhe te varrezat e dëshmorëve</p> <p>Homazhe pranë Obeliskut të “Gazetarit “Kerim Lawton me rastin 3 Majit , Dita e Shprehjes se Lire.</p> <p><u>Vërejtje:</u> Ndalim i aktiviteteve te tjera kulturore shkak i Covid-19</p>	

<p><b>QERSHOR</b></p>	<p><i>Manifestimi kulturor, kushtuar 14 Qershorit – Dita e çlirimit të Komunës së Vitisë.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 qershori – Dita ndërkombëtare e fëmijëve</li> <li>• Homazhe te varrezat e dëshmorëve</li> <li>• Koncert festiv</li> <li>• Ekspozitë e artit pamor</li> <li>• 05 qershori – Dita e Tokës</li> <li>•</li> <li>• Vizitë e grupeve artistike nga Vitia, komunave të tjera si dhe Shqipërisë</li> <li>• Pjesëmarrja e G. Artistike në festivalet e Dejës, Kaçanikut dhe Tropojës.</li> <li>• Koncert për fëmijë ,me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve</li> <li>• Shfaqje filmi për fëmijë</li> <li>• Ditët e skenës teatrore në Viti.</li> <li>• Lajmërimet/posterat e “2 korrikut”</li> </ul>	<p>Homazhe te varrezat e dëshmorëve me rastin e 14 Qershorit, Ditës së çlirimit të Vitisë</p> <p><b>Program kulturor me fëmijë ne amfiteatrin veror ne park</b></p> <p>U organizua pastrimi i qytetit me qytetar, Policin, FSK dhe KFOR</p> <p><u>Vërejtje:</u></p> <p>Ndalim i aktiviteteve të tjera kulturore shkaku i Covid-19 (Anulim i aktiviteteve sipas rekomandimeve të IKShPK)</p> <p><b>Më 01.06.2020</b>, kemi realizuar Koncert për fëmijë me rastin e Ditës Botërore të fëmijëve ne bashkëpunim me OJQ “Kori i Qytetit” dhe Çerdhja e fëmijëve sipas masave të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë.</p> <p><b>Më 25.06.2020</b>, është mbajtur audicion Muzikor për Fëmijë “ nga OJQ “Kori i Qytetit” – Viti, sipas masa masave të ndërmarrja nga Ministria e Shëndetësisë, me nxënësit e shkollave fillore të Komunës së Vitisë.</p> <p>Dizajni i njoftimit dhe agjendës për 2-3 korrik</p>	
-----------------------	---	--	--

P.s. në kalendarë janë të përfshira aktivitetet kulturore, pa inkorporim të takimeve në realizimin e këtyre aktiviteteve.

Pasqyra tabelare e aktiviteteve të mbajtura në Shtëpinë e Kulturës, në periudhën Janar - Qershor/2020								
	Institucione t komunale	OJQ-të	Ekspozita	Promovim i i librit	-Shfaqje filmi -Dokumentar -Teatri-Baleti	Partitë politike	Personat privat (Libri)	Gjithsej
Numri i aktiviteteve	13	12	2	1	1	0	0	29

Numri i pjesëmarrësve	1130	700	150	70	400	0	0	2450
Orët e punës gjatë orarit shtesë të aktiviteteve të lartshënuara								
Orët shtesë	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Gjithsej	
Orët	-//-	-//-	-//-	-//-	-//-	-//-	-//-	-//-

### III. Shpërndarja e Subvencioneve:

(Nga kodi buxhetor subvencione i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe nga Kodi buxhetor Subvencione i Kryetarit të Komunës)

Për shkak të sëmundjes infektive, pandeminë Coronavirus - Covid 19, ende nuk kemi marre vendim për mbështetjen financiare për OJQ-te deri me teani, për shkak se që nga 13 Marsi 2020 janë anuluar anuluar aktivitetet Kulturore, Sportive dhe Rinore.

Kurse nga 1 Qershori kemi filluar sipas rekomandimeve te parapara nga instituti kombëtar i shëndetësisë.

### IV. Projektet e Përfituara:

#### a) Projektet e Implementuara:

Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport: 2,000.00€ “Ditet e skenës teatrore ne Viti“

Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport: 1200.00€ në pasurimin e fondit Bibliotekar,

Donatorët e Bibliotekës: Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport: nga ana e Ministrisë për shkak te Virusit Covid-19, jemi shpallur fitues por ende nuk kemi pranuar donacionin nga ana e Ministrisë se Kulturës për vitin 2020.

Esat Kamberi, Bardh Frangu, Besjana Rexhepi, Kastriot Veselaj te cilët dhuruan:

17 Tituj, 24 Ekzemplarë.

#### c) Projekte të Planifikuara të fillojnë implementimin në gjashtëmuorin e dytë:

**Bashkimi European CHB Kosovo:** Restaurimi i objektit “Muzeu Komunal” Viti

**Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport:** Palestra Sportive në Drobesh

**Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport:** Projekti i renovimit të Shtëpisë së Kulturës

**Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport:** Renovimi i stadiumit ne Viti

**Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport:** Renovimi i stadiumit ne Pozheran

**Federata e Futbollit të Kosovës:** Rregullimi i zhyeshtoreve ne Stadiumin ndihmës ne Sadovine te Jerlive.

# DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Ky raport është i bazuar në kërkesat dhe detyrave të cilat jemi të obliguar që në harmoni me planet që janë të dale nga: “Plani zhvillimor Komunal” nr.01-013/126 i datës 07.02.2011, ”Plani zhvillimor Urban” me nr. 01-013/126 i datës 07. 02. 2011,

Planet rregulluese: “Zona Qendrore dhe Jugore dhe Lumi” me nr.01-013/1275 i datës 21.02.2013 si dhe “Zona Veriore” me nr.01-013/869 i datës 08.10.2013.

Implementimin e kriterëve ndërtimore të dalë nga: ”Rregullorja për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të objekteve në Komunën e Vitisë” nr. 01-013/317 të datës 15.03.2011.

Kontrollimi i planeve rregulluese detale të miratuara në raport me kërkesat për ndërtim nga qytetaret.

Kërkesa për dhënien e informatave për parcelat të ndryshme se çfarë destinim kanë me plane zhvillimore komunale dhe urbane .

Gjatë periudhës gjashtëmujore të vitit 2020, kjo drejtori ka kryer këto punë dhe aktivitete të përshkruara sipas planit të punës për vitin 2020 :

Jan kryer këto punë dhe aktivitete të përshkruara sektor për sektor :

## ▪ **Sektori i Urbanizmi ;**

### **Gjithsej : 16 .kërkesa**

❖ <b>Kërkesa për pëlqime urbanistik.....</b>	<b>05</b>
• Të shqyrtuara .....	03
• Të miratuara .....	01
• Të refuzuara .....	02
• Në proces .....	02
❖ <b>Kërkesa për leje ndërtimore .....</b>	<b>07</b>
• Të shqyrtuara .....	04
• Të miratuara .....	04
• Të refuzuara .....	00
• Në proces.....	03
❖ <b>Kërkesa për leje përdorimi .....</b>	<b>02</b>
➤ Të miratuara .....	01
➤ Në proces .....	01
❖ <b>Kërkesa për Legalizim .....</b>	<b>02</b>
➤ Të miratuara .....	00
➤ Në proces .....	02

## ▪ **Sektori i Planifikimit ;**

- ❖ Është punuar në ekip komunale për vlerësimin e zbatueshmerisë së Dokumenteve të Planifikimit PZHK dhe dhe PZHU-së, dhe përgatitjen për hartimin HZK;
- ❖ Janë përfunduar profili dhe analiza dy kaptinat për Planin Zhvillimor Komunal;
- ❖ Është përfunduar hartimi i Planin e Menaxhimit të Mbeturinave, Plani i cili tani është i draftuar dhe është procedurë të aprovimit në Kuvend;

❖ **Është përfunduar hartimi i Rregullores për Mbeturina e cila po ashtu është në procedurë të aprovimit në Kuvend:**

❖ **Në sektorin e planifikimit janë shqyrtuar 13. kërkesa të ndryshme**

**Kërkesa për dhënie të informatave urbanistike.**

❖ Gjithsejtë kërkesa: .....12

➤ të shqyrtuara : .....12

➤ Në proces ..... 00

❖ vendime për kushte të ndërtimit t ..... 1

➤ vendime për kushte të ndërtimit në proces..... 1

▪ **Sektori i Mjedisit :**

• **Shpallja e vitit 2020 vit I ambientit në Komunën e Vitisë me vendim të Kryetarit të Komunës së Vitisë z.Sokol Haliti.**

➤ Gjatë kësaj periudhe është shënuar “Dita Botërore e Mjedisit” më 05.qershor 2020 në aksion ku nën masat e parapara nga ISHPK kanë marrë pjesë mbi 200.pjesëmarrës dhe janë larguar mbi 100. thasë mbeturina, janë mbjellur 300.fidane lulesh dhe 30.drunjë dekorativ në parkun e qytetit dhe në shëtitoren rreth lumit “Morava e Binçës.

➤ Aktivitete të pastrimit të ambientit në bashkëpunim me këshillat e fshatrave janë shënuar edhe në disa fshatra të Komunës.

➤ Në bashkëpunim me MMPH janë vizituar dhe listuar objektet dhe zonat e mbrojtura të natyrës;

➤ Në vazhdimësi është bërë vlerësimi i gjendjes mjedisore është bërë grumbullim i informatave nga terreni lidhur me çështjet mjedisore, të cilat janë në një Raport të Zgjeruar Mbi Gjendjen e Mjedisit në Komunën e Vitisë;

➤ Është lëshuar **1. Leje Mjedisore Komunale** për veprimtari;

➤ Në bashkëpunim me Institutin për Mbrojtje të Natyrës nga AMMK – MMPH, kemi përcaktuar shtatë zona me vlera të mbrojtura të natyrës për të cilat është marrë vendim në Kuvendin Komunal për mbrojtje.

**Zyra e Adresave :**

➤ Janë bërë një marrëveshje bashkëpunimi në mes Zyrës së Adresave të komunës së Vitisë, Agjencionit Kadastral dhe shtetit Norvegjez ,ku jemi përfitues të donacionit në vlerë mbi 15.000€ ,i cili është i dedikuar për vendosjen e numrave nëpër objekte. Ndërsa tjetrën shumë do ta siguroj komuna në bazë të marrëveshjes së lartcekur.

➤ Janë futur të dhënat në Sistemin ARIS për një periudhë që e ka caktuar Agjensioni Kadastral.

**Sfidat:**

• Një ndër sfidat kryesore të kësaj drejtorie është pa mundësia e harmonizimit të kërkesave ndërtimore, sepse ekziston një dallim shumë i madhe në mes të PZHK-së, planeve rregulluese dhe kërkesave të qytetarëve për ndërtim.

• Numër i vogël i personelit profesional nga mungon një ndërtimtar, një aktikekt,një specialist i GIS-it dhe një jurist i specializuar për fushën e ndërtimit e që me ligjin mbi administrimin e pushtetit lokal nuk na lejohet rritja e punëtorëve.

• Përfundimi i hartimit të PZHK-së, Hartës Zonale të Komunës dhe ndryshimi i planeve tjera hapësinorë.



# DREJTORIA PËR KADASTER, PRONË DHE GJEODEZI

Gjatë kryerjes së punëve dhe shërbimeve administrative ne Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi janë aplikuar të gjitha ligjet që rregullojnë çështjet pronësore dhe të fushës së Gjeodezisë, e gjithë puna për këtë periudhë ka qenë e bazuar ne dispozitat ligjore ne fuqi. Përkushtimi ka qenë maksimal, që të gjitha transaksionet pronësore dhe shërbimet tjera që ofron DKPGJ-ja te kenë bazament këto Ligje, Udhëzime Administrative, Korniza Pune dhe Udhëzues Pune, po ashtu si akte tjera juridike bazë për ta bërë një transaksion gjithmonë jemi bazuar në aktgjykimet e plotfuqishme të Gjykatave, aktvendimet dhe kontratat e Zyrave Noteriale dhe akteve administrative tjera të sjellura nga organet Komunale.

## Korniza Pune

- Kornizë pune për Standardizimin e Matjeve dhe Rilevimeve Kadastrale.
- Korniza për Korrigjimin e Sipërfaqeve.
- Modelimi i dorëzimit të Dhënave në Regjistrin në Kadastër.

## Sektorët e DKPGJ-së

Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi, është e rregulluar me një sistemim dhe në bazë të organogramit të brendshëm dhe përshkrimit të detyrave dhe obligimeve të punës të secilit zyrtar, ku aktualisht në këtë drejtori punojnë 9 zyrtar të cilët janë me kualifikimet e nevojshme për ti plotësuar nevojat e punës dhe të funksionimit të secilit sektor në Drejtori.

Në kuadër të DKPGJ-së ekzistojnë tre sektorë:

- Sektori i Kadastrit
- Sektori i Pronës, dhe
- Sektori i Gjeodezisë

## Sektori i Kadastrit

Puna në Sektorin e Kadastrit është e bazuar në dispozitat ligjore, të cilat e rregullojnë këtë sektor, i cili është përgjegjës për kujdesen dhe mirëmbajtje e të gjitha regjistrave kadaslral, ku përfshihet e gjithë paluajtshmeria komunale, si dhe regjistri i paluajtshmerive, hipotekave, servituteve digjitale dhe manual, si shërbim kryesor për qytetarët si shërbimi me lëshimin e fletave poseduese, çertifikatave personale dhe social.

Gjatë kësaj periudhe në këtë sektor janë kryer këto shërbime kadastrale:

Muaji	Fleta poseduese Me/pa pagës	Certifikata për N. sociale	Hipoteka	Transaksione Pronësore
Janar	395me/7pa	85	4regj/2ç'regj	66 lëndë
Shkurt	530me/12pa	53	7 regj/4ç'regj	51 lëndë
Mars	350me/3 pa	72	4regj/3ç'regj	45 lëndë
Prill	99me/5pa	8	3regj/1ç'regj	19 lëndë
Maj	143me/2pa	5	6regj/3ç'regj	25 lëndë
Qershor	342me/9pa	105	7 regj/2ç'regj	81 lëndë

*Tabela nr.1 Shërbimet kadastrale për periudhën Janar – Qershor 2020*

## 4.2 Sektori i Pronës

Sektori i pronës ka përgatitë 5 propozim vendime për bordin e drejtoresve dhe Kuvendin komunal, ne lidhje me natyrën e punëve ne Drejtori në vazhdimësi ka bërë interpretimin e normave ligjore që janë në fuqi, ka kryer

punë administrative në Drejtori: përpilimin e aktvendimeve, urdhëresave dhe akteve tjera, ka lëshuar vërtetime për pronat që komuna nuk ka interes të blejë ato.

I ka pranuar kërkesat e drejtuara Drejtorisë, i ka shqyrtuar ato dhe ju është përgjigjur me shkrim. Ka zhvilluar procedurat për ekspropoim të tokave në pronësi private për interesa të përgjithshme publike.

### 4.3 Sektori i Gjeodezisë

Sektori i Gjeodezisë për gjatë vitit ka kryer këto shërbime për palët dhe Komunën si ka : Mirëmbajt kadastrën digjital në sistemin kosovaref01 ka përcjell vektorizimin e raster planeve, ka përgatitë dhe mbikëqyrë të dhënat për kompanitë dhe gjeodetët e licencuar, ka përgatitë raportet ditore për Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ka pranuar lëndët e kryera nga kompanitë dhe gjeodetët e licencuar dhe të njëjtat i azhurnon në sistemin zyrtar (SIKTK-T dhe SIKTK-G), ka bërë azhurnimin e ndarjeve fizike në librat e regjistrimeve të nënndarjeve kadastrale, ka bërë Hartimin e kopjeve të Planit, Kontroll të vazhdueshme kualitetit të të dhënave grafike kadastrale dhe atyre tekstuale, projektim të rrjeteve referente, të rendit të tretë të shtruar me GPS, Identifikim i parcelave në zyrë. Futja e të dhënave grafike në datamodelin zyrtar (SIKTK-G). Konsulta dhe këshilla profesionale në lëminë e Gjeodezisë dhe Kadastrës, për palët e interesuara në kuadër të shërbimeve kadastrale.

Muaji	Kopjet planit Me pag/pa pag	Produkte për kompanit ë private	Ndarje/azhurnime	Bashkim i parcelave	Ndërrim kulture
Janar	66/3	10	10ndarje/970azhurime	2	
Shkurt	73/3	12	50ndarje/45azhurime	5	
Mars	45/2	9	9ndarje/25azhurime	1	1
Prill	15/2	10	5ndarje/15azhurime	1	2
Maj	71/5	20	3ndarje/15azhurime	2	1
Qershor	153 /5	32	6ndarje/12azhurime	4	3

Tabela Nr.3 Shërbimet në sektorin e Gjeodezisë

#### 1. Të hyrat financiare

Në Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi planifikimi i të hyrave buxhetore për vitin 2020 duke përfshirë të gjithë sektorët ka qenë 80,200.00€, kurse realizimi i të hyrave deri në periudhën Janar – Qershor 2020 është 19,911.00 €.

#### Sfidat

##### Pengesat të cilat i ka përcjell këta Sektorë janë:

- Mungesa e shënimeve prej vitit 1982 – 1999.
- Lidhjet e dobëta digjitale në bazën e të dhënave dhe shpeshherë ndërprerja e tyre kohë pas kohe me Agjencinë Kadastrale të Republikës së Kosovës.
- Mungesa e shënimeve gjeodezike nga viti 1985 – 1999.
- Mungesa e planeve/skicave për zonat kadastrale, të cilat janë pjesë të komasacionit.

##### Propozim masat të cilat duhet të merren për efikasitet janë:

- Insistimi i faktorëve institucional, vendor dhe ndërkombëtar tek Institucionet e Serbisë për kthimin e shënimeve kadastrale dhe gjeodezike, respektivisht planeve gjeodezike.

- Insistimi i institucioneve vendore dhe i mekanizmave ndërkombëtar tek institucionet e Serbisë, për kthimin e dokumentacionit kadastral, të konfiskuar (grabitur gjatë luftës).
- Përpjekjet për përmirësimin e lidhjeve digjitale në bazën e të dhënave me Agjensionin Kadastral të Republikës së Kosovës.

## **DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL**

Në këtë periudhë raportuese, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural i ka kryer te gjitha procedurat për fermerët që kanë të bëjnë më: plotësimin e aplikacioneve, dhënien e këshillave, ne mënyrë qe këta fermer te jene përfitues te mundshëm te subvencioneve dhe grandeve të ndarë nga niveli qendror dhe komuna.

Drejtorja për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, gjatë periudhës Janar-Qershor 2020 ka kryer këto aktivitete të punës, gjithmonë bazuar në planin vjetor të punës, të hartuar për vitin kalendarik Janar – Dhjetor 2020.

Gjatë kësaj periudhe janë kryer këto punë:

- Hartimi i planit të punës vjetor për vitin kalendarik 2020,
- Planet e punës mujore,
- Planet e punës gjashtëmujore,
- Raportet e mujore të punës,
- Punët rutine të kryera,
- Seminare dhe takime të ndryshme,
- Hartimi i projekteve,
- Vizita ne teren, regjistrime, evidenca, statistika, këshilla etj.

Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, aktivitetet e saja i kryen përmes 3 sektorëve: Sektori për Bujqësi dhe Blegtori, Sektori për Pylltari dhe Sektori për Zhvillim Rural.

### **Sektori për Bujqësi dhe Blegtori**

Gjatë këtij viti janë bërë vizita të shumta në teren për grumbullimin e shënimeve në ferma, (është bërë rifreskimi i të dhënave mbi gjendjen në përgjithësi në të gjithë sektorët e bujqësisë me të dhëna te reja.

Hartimi i planeve mujore të vizitave në teren për grumbullimin e shënimeve në ferma,

Hartimi i planit të mbjelljeve pranverore për vitin 2020,dhe realizimi i mbjelljeve pranverore .

Përcjellja e statistikave bujqësore 54 vizita për vlerësime të dëmid.

Kontrollimi i materialit fidanor gjithsej 25

Kontrollimi dhe vizita e bletarëve 15

Kontrollimi dhe vizita në ferma blegtorale gjithsej 20 vizita

Kontrollimi dhe vizita e pemëve te imta gjithsej 10 vizita

Pranimi dhe plotësim i formularëve si dhe regjistrimi i pronave të fermerëve për subvencione,

Ende nuk ka filluar afati për kemi bërë vlerësimin e damit në fermën e djegur, në F.Sh . Remnik.

DBPZHR dhe IKC, vizitë te 6 fermerë aplikues për maikn të Mbjelljes së specave dhe lakrës.

### **Grandet dhe Subvencionet nga Komuna dhe Donatorët:**

#### **Komuna e Vitisë me Organizaten Caritaci Zvicrran :**

1. DB në bashkëpunim me Caritasin Zvicrran ka bërë shpërndarjen e mjeteve për Bimë Mjekuese Aromatike dhe dredhëz.
2. Në kuadër të pakove, fermerët janë pajisur me: Rezervuar të ujit, gypi për system pike-pikë, foli e zezë, telë për rrethojë, shtylla, pompa për spërkatje, plehra, kabinete metalike për ruajtjen e preparateve, gajbe etj.
3. Gjithsej janë 13 fermerë, prej tyre 6 janë përfitues të BMA dhe 7 fermerë me fidane të dredhëzës.

## **Vlera e projektit: 72,000.00 Euro**

### **Komuna e Vitisë dhe Organizata UNDP-ja**

Njëzet fermerë kanë përfituar sistemin e ujitjes pikë-pikë dhe fidane të bimëve aromatike mjekuese për 5 ari, në kuadër të projektit “ Promovimi i Sektorit të Bimëve Mjekësore Aromatike në Viti” I cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe Implementimet nga Programi për Zhvillim I Kombeve të Bashkuara ( UNDP), përmes Programit Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor ReLOaD.

### **Gjithsej Investimi 18,597.00**

#### **Sektori për Pylltari**

- Përgatitja e planit të prerjes ;
- Hartimi i planit operativ për mbrojtjen e pyjeve;
- Shqyrtimi i kërkesave për prerje në pyjet private;
- Takime te rregullta me stafin e pylltarisë, realizimi i detyrave të punës;
- Konfiskimi i masave të druve të vëna në qarkullim pa dokumentacionin e nevojshme, ku janë konfiskuar 19.20 m<sup>3</sup> dru;
- Gjatë pjesës së parë vitit 2020 janë mbyllur disa rrugë në pyje me qëllim të pengimit të prejeve ilegale të pyjeve, ku kan ndikuar mjaftë në zvogëlimin e dëmeve;
- Gjatë vitit 2020 janë mbajtur disa takime me Kryetarin e komunës, Komandantin e Stacionit Policor në Viti dhe Kryetarin e Gjykatës Themelore dega në Viti me qëllim të koordinimit të aktiviteteve për ndalimin e prerjeve ilegale;
- Në bashkëpunim me Policinë janë realizuar disa kontrolla rutine në tregje dhe rrugë kyqe që kanë rezultuar me konfiskim të masës drusore të prerë ilegalisht;
- Gjatë periudhës gjashtë mujore nga ana e rojeve të pyllit janë bërë gjithsejtë 52 fletëparaqitje për dëme në pyje.

#### **Komuna e Vitisë dhe Organizata IKC:**

Komuna dhe IKC kanë shpërndarë mekanizëm për mbjelljen e fidanëve të lakrës dhe specave. Përfitues 18 fermerë vitias.

## **Vlera e projektit: 81,650.00 Euro**

### **Aktivitetet e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural gjatë**

#### **Pandemisë- Covid 19**

Siç dihet Komuna e Vitisë ishte e para në nivel vendi e cila u ballafaqua me Pandeminë, edhe gjatë kësaj kohe ka patur aktivitete të cilat janë kryer sipas Vendimeve të marra nga Komuna e Vitisë, Vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë, MBPZHR dhe duke iu përmbajtur Vendimeve të Qeverisë.

Aktivitetet janë kryer falë zhvillimit të teknologjisë siq janë: email adresave, facebook, viber etj.

Përmes email adresës është punuar në Draft e Masën 303, lidhur me LIDERIN dhe Funksionalizimi I GLV-ve.

Përmes rrjeteve sociale është bërë formimi i grupeve të grave dhe fermerët për informim dhe bashkëpunim lidhur me aktivitetet bujqësore.

**Me datë: 14.04.2020-** Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, gjegjësisht Ministri Besian Mustafa, përmes kërkesës në facebook bëri thirrje, se puna e bujqve tonë nuk do të ndalet

Me këtë kërkesë do të vlejné masa lehtësuese dhe do t’iu krijohet mundësi pune për bujqit që tani janë në kulmin e punës në fushë., kjo do të arrihet përmes paisjes me Numër Identifikues të Fermës ( NIF)

**Me datë: 15.04.2020-** Zyrtarët e Drejtorisë së Bujqësisë menjëherë iu kanë përgjigjur thirrjes së Ministrit të Bujqësisë duke i paisur fermerët me NIF, e që gjithsej janë pajisur 450 fermerë, kuptohet duke iu përmbajtur kriterëve siç janë: distanca, maska dhe dorezat.

**Me datë: 20.04.2020.-Viti-** Ministri i Bujqësisë viziton Vitinë ku së bashku me Kryetarin e Komunës ata bëjnë vizitë direkt në fermat e fermerëve

**Me datë: 28.04-20.05.2020- Viti-** Thirrja për aplikim -makina për mbjelljen e fidaneve të perimeve dhe makinë tharëse.

**Me datë: 09.05.2020- Viti** – Njëzet fermerë kanë përfituar sistemin e ujitjes pikë-pikë dhe fidane të bimëve aromatike mjekuese për 5 ari, në kuadër të projektit “ Promovimi i Sektorit të Bimëve Mjekësore Aromatike në Viti” I cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe Implementohet nga Programi për Zhvillim I Kombeve të Bashkuara ( UNDP), përmes Programit Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor ReLOaD.

**Nga data: 08.05.-14.05.2020- Viti** – është bërë vlerësimi i dëmeve të produkteve të mbetura – dëmtuara të fermerëve gjatë Pandemisë Covid 19.

Ky vlerësim është bërë në bazë të kërkesës nga MBPZHR – gjegjësisht nga zv. Ministri i Bujqësisë.

**Me datë: 18.05.2020- Viti** – Është bërë një shndërrim i Tokës Bujqësore në atë ndërtimore.

**Me datë: 18.05.2020.-Viti-** Është bërë vlerësimi i dëmeve në serra të shkaktuar nga era me shpejtësi të madhe e datës: 15.05.2020 në Viti. Raportet janë dorëzuar në MBPZHR.

**Me datë: 19.05.2020- Viti** – DB në bashkëpunim me Caritasin Zvicerran ka bërë shpërndarjen e mjeteve për Bimë Mjekuese Aromatike dhe dredhëz.

Në kuadër të pakove, fermerët janë pajisur me: Rezervuar të ujit, gypi për sistem pike-pikë, foli e zezë, tel për rrethojë, shtylla, pompa për spërkathe, plehra, kabinete metalike për ruajtjen e preparative, gajbe etj.

Gjithsej janë 13 fermerë, prej tyre 6 janë përfitues të BMA dhe 7 fermerë me fidane të dredhëzës.

Zyrtarët për çdo gjë i kanë informuar fermerët nga zyra dhe nga rrjetet sociale.

### **Të hyrat nga taksat komunale që i përkasin Drejtorisë së Bujqësisë**

Duke u bazuar në të hyrat që krijohen nga grumbullimi i taksave komunale nga domeni i bujqësisë paraqitet kjo gjendje ;

Të hyrat nga :

- Ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në atë ndërtimore : 2182 €, dhe
- Certifikata për veprimtari bujqësore : 30 €

**Gjithsej të hyra : 2182 €**

### **Shqyrtimi i kërkesave të drejtuara përmes arkivit të komunës**

Gjatë këtij gjashtëmujori nga arkivi i komunës kanë arritur gjithsej 65 kërkesa, prej tyre:

<b>Të bartura nga viti paraprak</b>	<b>Të pranuar Janar-Qershor</b>	<b>Gjithsej të pranuar</b>	<b>Të miratuara</b>	<b>Të refuzuara</b>	<b>Gjithsej të shqyrtuara</b>
<b>/</b>	<b>65</b>	<b>65</b>	<b>65</b>	<b>0</b>	<b>65</b>

Kurse, sa i përket kërkesave që i drejtohen drejtorisë pa procedurë të arkivit, numri i tyre është i madh dhe kryesisht kanë të bëjnë me shqyrtimin e mundësisë së subvencionimit të kulturave bujqësore që kultivohen nga ana e tyre.

Viti, korrik 2020

Kryetari i Komunës  
Sokol HALITI